



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria për Shërbime Publike
Uprava za Javne Službe / Directorate for Public Services

Data/Datum/Date:	20.01.2023
Nr./Br./No.	08/02
Për/Za/To:	Kuvendi Komunal Shtime
Përmes/Preko/Through:	Kryetari i Komunës, Demajl Aliu
Nga/Od/From:	Drejtor për Shërbime Publike: Bardhyl Rushiti
Lënda/Predmet/Subject:	Propozim i Draft Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave 2022-2026

Drejtoria e Shërbimeve Publike, i propozon Kuvendit për miratimin e Draft Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2022-2026.

Për hartimin e këtij draft dokumenti janë marrë në konsideratë këto ligje; Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin 04/L-060 për Mbeturinat, Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat.

Hartimi i Draft Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2022-2026 është në harmoni edhe me veprimet dhe masat në nivel lokal të përcaktuara me dokumente strategjike lokale.

Të bashkëlidhur e gjeni dokumentin Draft Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2022-2026.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Draft Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturineve 2022-2026

Janar, 2023

<i>Fjala e Kryetarit të Komunës</i>	<i>7</i>
<i>1 Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave</i>	<i>8</i>
1.1 Qëllimi dhe fushëveprimi i planit.....	8
1.2 Baza ligjore dhe institucionale për rishikimin e planit.....	9
1.4. Konteksti lokal	11
<i>1.5. Të dhënat për mbeturina në komunë</i>	<i>24</i>
1.6. Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave	24
1.7. Rishikimi i implementimit të planit	27
1.8. Performance e shërbimit	30
1.9. Performanca financiare e MM	31
1.10. Infrastruktura për ndarje, riciklim dhe deponim të mbeturinave.....	33
1.11. Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave.....	33
<i>2. Objektivat e MM dhe plani operacional.....</i>	<i>34</i>
2.3. Vizioni i MM	34
2.4. Objektivat dhe caqet e MM	34
<i>3. Plani i MM në kushte emergjente</i>	<i>48</i>
<i>4. Plani financiar, i veprimeve dhe i monitorimit.....</i>	<i>49</i>

Lista e shkurtesave:

AMMK	Agjencioni i Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BMZ	Ministria federale gjermane për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik
CEDE	Qendra për Edukim dhe Zhvillim të Mjedisit
DRS	Sistemi i kthimit të depozitës
ELV	Automobila mbeturinë
EPR	Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit
GIZ	Ministria federale gjermane për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik
QeK	Qeveria e Kosovës
ITMB	Impijanti për trajtimin mekanik biologjik
IWMS	Sistemi i menaxhimit të integruar të mbeturinave
JICA	Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau
KIWER	Instituti i Kosovës për hulumtim të ujit dhe mjedisit
KLMC	Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave
MESPI	Ministria e mjedisit planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës
MND	Mbeturina nga ndërtim demolimi
MPEE	Mbeturina nga pajisje elektrike dhe elektronike
MRF	Qendra e rikuperimit të materialit
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PKMM	Plani komunal për menaxhim të mbeturinave
PPP	Partneriteti publik privat
PZP	Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit
SIMM	Strategjia e integruar e menaxhimit të mbeturinave
WFD	Direktiva kornizë e mbeturinave

Lista e tabelave

Tabela 1	Të dhënat mbi popullatën
Tabela 2	Emetimet totale vjetore të emisioneve në ajër në komunën e Shtimes sipas sektorëve dhe ndotësve ton/vit
Tabela 3	Numri i bizneseve të komunës së Shtimes sipas llojit të veprimtarisë
Tabela 4	Struktura e institucioneve arsimore dhe e nxënësve
Tabela 5	Numri dhe pozitat e të punësuarave në QKMF të Shtimes
Tabela 6	Numri i të punësuarve në administratën e Komunës së Shtimes
Tabela 7	Dokumentet relevante komunale, afati i zbatimit të tyre dhe ndërlidhja me menaxhimin e mbeturinave
Tabela 8	Bilanci i mbeturinave komunale
Tabela 9	Operatorët e mbeturinave nën përgjegjësi komunale
Tabela 10	Mbulimi me shërbim në territorin e komunës
Tabela 11	Mbulimi i ofrimit të shërbimit për EF sipas vendbanimit
Tabela 12	Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit
Tabela 13	Pajisjet për hudhjen, ruajtjen dhe grumbullimin e mbeturinave
Tabela 14	Pajisjet për grumbullim dhe transport të mbeturinave
Tabela 15	Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual
Tabela 16	Efikasiteti i stafit të shërbimeve të MM
Tabela 17	Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave
Tabela 18	Shpenzimet e sistemit të MM
Tabela 19	Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM
Tabela 20	Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit
Tabela 21	Lista e objektivave të planit
Tabela 22	Korniza strategjike e Objektivit 1
Tabela 23	Korniza strategjike e Objektivit 2
Tabela 24	Parashikimet demografike të populates
Tabela 25	Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave
Tabela 26	Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave sipas kompozicionit
Tabela 27	Analiza e potencialit të mbeturinave që mundën të ricikohen
Tabela 28	Orari i ndarjes së mbeturinave në burim
Tabela 29	Korniza strategjike e objektivit 3
Tabela 30	Strategjia e zgjerimit me shërbim
Tabela 31	Efikasiteti i stafit
Tabela 32	Korniza strategjike e objektivit 4
Tabela 33	Korniza strategjike e objektivit 5

Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave 2022-2026

Tabela 34	Plani financiar, veprimet dhe monitorimet - Objektivi 1 „Parandalimi dhe reduktimi“
Tabela 35	Plani financiar, veprimet dhe monitorimet - Objektivi 2 „Ripërdorimi dhe riciklimi“
Tabela 36	Plani financiar, veprimet dhe monitorimet - Objektivi 3 „Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme“
Tabela 37	Plani financiar, veprimet dhe monitorimet - Objektivi 4 „Deponimi i sigurtë si mjet i fundit“
Tabela 38	Plani financiar, veprimet dhe monitorimet - Objektivi 5 „Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për MM“

Fjala e Kryetarit të Komunës



Për komunën e Shtimes, që nga fillimi i funksionimit të saj, menaxhimi i mbeturinave është konsideruar si një sfidë me të cilën kjo komunë duhej të përballlej dhe të gjejë një zgjidhje afatgjatë. Nevoja për investime në kushte e rrethana të kufizuara financiare, nevoja për ndërgjegjësimin e qytetarëve por edhe problemet në interpretimet ligjore kanë bërë që kjo sfidë të jetë aktuale edhe sot e kësaj dite.

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë, komunat janë kompetente për sigurimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë këtu furnizimin me ujë, kanalizimin, trajtimin e ujërave të zeza dhe menaxhimin e mbeturinave, mirëpo mospërputhja e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe pronësia e ndërmarrjeve publike ka bërë që problematika e menaxhimit të mbeturinave të ngritët në një nivel më të lartë të shqyrtimit dhe analizës. Sipas Ligjit për Mbeturinat, komunat kanë të drejtë t'i përgatisin planet e veta lokale për menaxhimin e mbeturinave të ngurta dhe t'i bëjnë planet e duhura operative për grumbullimin e mbeturinave në mënyrë më efektive.

Sidoqoftë, angazhimi i komunës si institucion që të vihet në shërbim të qytetarëve asnjëherë nuk është vënë në pyetje, pa marrë parasysh sfidat dhe problemet qoftë financiare, funksionale apo ligjore.

Në këtë drejtim përgatitja e një dokumenti për "menaxhimin e mbeturinave" vetëm sa e dëshmon seriozitetin dhe përkushtimin e komunës së Shtimes që këtij problemi t'i qaset me tërë kapacitetin e vet, dhe të jetë komuna e parë në Republikën e Kosovës që do ta ketë një dokument gjithëpërfshirës.

Harmonizimi i këtij dokumenti me legjislacionin kombëtar dhe Direktivat e BE-së na bënë të besojmë se kemi arritur të hartojmë një strategji afatgjatë të menaxhimit të mbeturinave.

Koncepti i detajuar për menaxhimin e mbeturinave në qytet dhe në vendbanimet rurale të Shtimes, themelimi i një rrjeti funksional për grumbullimin e mbeturinave, krijimi i një plani për menaxhimin e mbeturinave dhe mbështetja financiare e programeve për ngritjen e vetëdijes publike si dhe themelimi i një ndërmarrjeje publike që i parasheh ky dokument, do të jetë strategjia e komunës së Shtimes për ta menaxhuar këtë problematikë në mënyrë afatgjatë. Për të ardhur deri te ky dokument është dashur kohë, angazhim dhe përkushtim i grupit punues të komunës së Shtimes i cili në mënyrë të veçantë e ka shtjelluar këtë problematikë në përputhje me planet zhvillimore strategjike.

Në veçanti falënderojmë partnerët tanë nga Projekti GIZ-SMS, BE-së, dhe organizatave KIWER dhe CEDE që kanë ofrruar mbështetje në procesin e rishikimit të planit komunal duke punuar ngushtë me grupet punuese të komunës.

Kryetari i Komunës

Qemajl Aliu

1 Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave

1.1 Qëllimi dhe fushëveprimi i planit

PKMM-ja paraqet dokumentin bazë me të cilin organizohet procesi i menaxhimit të mbeturinave në nivel të Komunës. Komuna e Shtimes është e përcaktuar që të përmirësoj gjendjen e menaxhimit të mbeturinave dhe në këtë drejtim ka parashtruar qëllimin dhe objektivat specifike që janë pjesë integrale e këtij plani. Qëllimi i PKMM është ofrimi i kornizës strategjike për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave për periudhën pesëvjeqare për territorin e administruar nga komuna në pajtueshmëri me dispozitat ligjore dhe kornizën planifikuese strategjike.

Qëllimi i PKMM është ofrimi i kornizës strategjike për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave për periudhën pesëvjeqare për territorin e administruar nga komuna në pajtueshmëri me dispozitat ligjore dhe kornizën planifikuese strategjike. PKMM trajton vetëm mbeturinat e ngurta, dhe nuk përfshihen mbeturinat e veçanta të cilat nuk janë kompetencë e komunës. Por do të përfshij raportimin e këtyre mbeturinave te institucionet përgjegjëse siç është MMPH.

PKMM ka si qëllim që të mundësojë dhe të sigurojë:

- Përputhshmëri me Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave (SRKMM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave dhe arritjen e objektivave kombëtare të paracaktuara në fushën e menaxhimit të mbeturinave;
- Identifikimin e prioritetëve në sektorin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas një Plan Veprimi.
- Opsionet më të mira për menaxhimin e mbeturinave: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave në përputhje me objektivat kombëtare.
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementëve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbeturinat në të gjithë sistemin e menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standardet e menaxhimit të tyre.
- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave;
- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbeturina sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

PKMM do të shërbej si kornizë planifikuese dhe e veprimit për implementimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, hartimin e buxheteve, përpilimin e planeve investuese, si dhe tërheqjen e asistencës së jashtme.

1.2 Baza ligjore dhe institucionale për rishikimin e planit

1.2.1 Korniza ligjore për MM

Akti themelor për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë është Ligji 2011-04 L 060 për Mbeturinat i cili rregullon aspektet specifike të menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe llojeve tjera të mbeturinave. Ligji në fjalë ndërmjet tjerash ofron parimet bazë mbi menaxhimin e mbeturinave përfshi klasifikimin e mbeturinave si dhe rolet e përgjegjësive të aktorëve kyq në menaxhimin e tyre, si aspektet e operimit, dhe licencimit të operatorëve.

Në mënyrë specifike Ligji i Mbeturinave përmes Nenit 15 i përcakton kompetencat e komunave sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Komunitet sipas këtij Neni janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e Planeve Komunale të Menaxhimit të Mbeturinave, krijimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, përzgjedhjes së operatorëve të licencuar si dhe përcaktimit të tarifave dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve. Ligji i mbeturinave është hartuar në masë të konsiderueshme me direktivat përkatës të KE që e rregullojnë lëminë e menaxhimit të mbeturinave komunale dhe rrjedhave tjera të mbeturinave.

Korniza Ligjore përmban edhe një numër të konsideruar të ligjeve tjera sektoriale të cilat në mënyrë indirekte rregullojnë menaxhimin e mbeturinave. Këto Ligjë përfshijnë: Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, etj.

Neni 17 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përcakton menaxhimin e mbeturinave si kompetencë të komunave përfshi edhe aspektet e menaxhimit operativ dhe financiar të shërbimit dhe buxhetimit .

Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ndërmjet tjerash rregullon aspektet relevante të pronësisë së ndërmarrjeve publike për menaxhimin e mbeturinave, udhëheqjen kooperative, transparencën financiare, dhe formimin e ndërmarrjeve komunale.

Baza ligjore për menaxhimin e mbeturinave në nivelin lokal të Komuna e Ferizajt përfshinë:

- Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Shtimes;

Dokumentat tjera planifikuese-ligjore në lëmin e menaxhimit të mbeturinave janë edhe:

- Strategjia (2021-2030) dhe Plani i Veprimit (2021-2023) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë- dokument strategjik që synohet të arrij zhvillimin e integruar dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave dhe të ndikoj në ruajtjen e shëndetit publik, zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Dokumenti synon të trajtojë të metat dhe kufizimet aktuale në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, duke i përcaktuar dhe realizuar objektivat strategjike.

Dokumente strategjike në nivel lokal që rregullojnë dhe trajtonë aspektet e menaxhimit të mbeturinave:

- Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Shtimes 2010-2020 - Është bazë për zhvillim të qëndrueshëm në komunën e Shtimes, dhe synon ruajtjen e mjedisit, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve për zhvillim ekonomik, për gjeneratat e ardhshme dhe balancimin e zhvillimeve hapësinore. Përmes këtij plani koordinohen kërkesat sociale dhe ekonomike për hapësirën me funksionet e saj kulturore dhe ekologjike.

- Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2021-2025- Dokument planifikues - strategjik, që adreson zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal për periudhën 5 vjecare. Në një kapitull të vecantë ky dokument trajton edhe aspektet e menaxhimit të mbeturinave.

1.3. Korniza institucionale për MM

Rolet dhe përgjegjësitë e akterëve kyq sa i përket menaxhimit të mbeturinave janë të sanksionuara me Ligjin mbi Mbeturina dhe aktet tjera relevante ligjore dhe nënligjore. Autoritet kryesore të menaxhimit të mbeturinave janë Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunitet e Kosovës.

Sipas Ligjit të Mbeturinave Ministria administron me mbeturinat e rrezikshme, mbeturinat toksike, mbeturinat likuide, industriale dhe të ngjashme. Komunitet nga ana tjetër menaxhojnë me mbeturinat komunale, mbeturinat inerte dhe nga demolimet, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat tjera jo të rrezikshme.

Neni 14 i Ligjit të Mbeturinave përcakton kompetencat e MMPH dhe këto kompetenca përfshijnë ndërmjet tjerash: (i). Hartimin e ligjeve, politikave strategjisë për menaxhimin e mbeturinave; (ii) zbatimin e strategjisë dhe masterplanit; (iii) dhënjen e licencave për operatorët; (iv) dhe krijimin e bazës së shënimeve dhe sistemit informativ për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 15 i Ligjit të Mbeturinave përcakton kompetencat e Komunave dhe këto kompetenca përfshijnë ndërmjet tjerash: (i) krijimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave; (ii) hartimin e planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave; (iii) përzgjedhjen e personave të licencuar për menaxhimin e mbeturinave; dhe (iv) caktimin e tarifave të mbeturinave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve.

Autoritet tjera për menaxhimin e mbeturinave janë:

- Ministria e Zhvillimit Ekonomik - Menaxhimi i Ndërmarrjeve Publike në Nivel Qëndror përfshi Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës; caktimi i tarifave për deponimin e mbeturinave
- Ministria e Shëndetësisë - Menaxhimin e Mbeturinave dhe Produkteve Medicinale
- Ministria e Punëve të Brendshme - Bënë koordinimin në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore e të tjera dhe sipas nevojës cakton anëtarët pjesëmarrës në komisionin për vlerësimin e dëmeve eventuale nga mbeturinat.
- Agjencioni i Veterinës dhe Ushqimit - është përgjegjës për rregullimin e aspekteve të menaxhimit me mbeturinat me prejardhje shtazore;
- Dogana e Republikës së Kosovës - kryen kontrollin, evidentimin dhe mbikëqyrjen e importit, eksportit dhe kalimit transit të mbeturinave
- Policia e Republikës së Kosovës - bashkëpunon me agjencionet dhe organizatat e vendeve tjera për identifikimin, luftimin dhe parandalimin e veprimeve të ndaluara dhe keqpërdorimit të mbeturinave.

Rolet dhe përgjegjësitë e organeve komunale në menaxhimin e mbeturinave janë paraqitur si në vijim:

- Drejtoria për Shërbimeve Publike (DSHPE) - është përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha punimeve në pronën publike dhe komunale, monitorimin e punëve të kompanive të angazhuara për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve dhe hapësirave tjera publike. DSHPE është përgjegjëse për caktimin e tarifave të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave mbeturinave komunale dhe ayre nga ndërtimi dhe demolimi,
- Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUKMM) është përgjegjëse për caktimin e një lokacioni për deponimin e mbeturinave inerte. DUKMM, është përgjegjëse edhe për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të rregulloreve komunale në lëmin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit.
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa - është përgjegjëse për propozimin e taksave, tarifave dhe ngarkesave tjera komunale si dhe inkasimin e tyre.
- KRM "Pastërtia" njësi në Shtime - ofron shërbim sipas statutit të saj duke ushtruar kompetenca ekzekutive.

1.4. Konteksti lokal

Pozita gjeografike dhe klima

Komuna e Shtimes ka një sipërfaqe prej 134km² (13.450,8ha), gjegjësisht 1,2 % të territorit të Kosovës. Shtrihet në pjesën Qendrore të Kosovës në koordinatat 42.43, 21.03. Kufizohet me komunat Lypjan në veri, Ferizaj në juglindje dhe Suharekën në perëndim. Gjatësia e pikave më të largëta në territorin e komunës është 19,8 km, në mes fshatrave Karaqicë në perëndim dhe Vojnoc në lindje. Gjerësia maksimale është 13,8 km në mes të komunave Pjetershticë në veri dhe, komunës kadastrale Topillë-Devetak në jug. Komuna e Shtimes ka pozitë të mirë gjeografike ngase ka lidhje të mira dhe funksionale me qendrat përreth. Qendra administrative, qyteti i Shtimes, është 31km larg kryeqytetit të Kosovës - Prishtinës, 45km larg Prizrenit dhe 13km nga Ferizaj, kurse nga Aeroporti Ndërkombëtarë Adem Jashari është larg vetëm km .

Pozita e qendrës komunale ndaj vendbanimeve të komunës është e mirë dhe nuk i ndanë distanca të largëta, por as pengesa natyrore që do ta vështirojnë komunikimin. Në pozitën e saj gjeografike lugina e Caralevës ka rëndësi komunikative, jo vetëm për komunën, por edhe në hapësirë më të gjerë. Rruga e asfaltuar Pjetershticë-Komoran e ka shkurtuar lidhjen me pjesët tjera të Kosovës kah perëndimi.

Komuna e Shtimes ka klimë të mesme kontinentale, me dimra mesatarisht të butë dhe me verë mesatarisht të nxehtë. Temperatura mesatare vjetore është 10.5 gradë Celsius. Muaji më i ftohtë është janari me temperaturë mesatare -9. Gradë Celsius, ndërsa më i ngrohi është korriku me 20.4 gradë Celsius. Mesatarja vjetore e reshjeve në territorin e komunës është 633 mm. Sasia më e lartë e reshjeve është regjistruar në muajin maj 81.3 mm, ndërsa ajo më e ulëta në muajin nëntor 41.7 mm. Mesatarja vjetore relative e lagështisë është 78.7%. Insolacioni vjetor është 2.153 orë. Vranësiat mesatare vjetore janë 52%. Shpejtësia mesatare vjetore e erës është 1.3 m/s në drejtim jug -perëndim dhe 2.8 m/s në drejtimin veri-perëndim. Pika më e ulët mbidetare në komunën e Shtimes është 545.7 m, ndërsa pika më e lartë mbidetare është 1,290 m. Rreth 54 % e sipërfaqës së komunës i takon lartësisë mbidetare deri në deri 700 m, rreth 27% e sipërfaqes së përgjithshme të komunës i takon lartësisë mbidetare 700-900 m, ndërsa që pjesa tjetër e sipërfaqës (rreth 17%) që përfshinë kryesisht zonat malore i takon lartësisë mbidetare mbi 900 m.

Resurset minerare- Komuna e Shtimes njihet për rezervat e mëdha të gurit gëlqeror, të cilat, sipas matjeve të kryera në vargmalet nga Carraleva në Topillë, janë rreth 2 milionë metra kub të cilësisë së lartë, ndërkohë që ka pritshmëri dhe për rreth 9 milionë metra kub rezerva të tjera të po kësaj cilësie, duke përbërë, në këtë mënyrë, një mundësi shumë të madhe për ngritjen e një industrie nxjerrëse dhe përpunuese për materiale që përdoren në sektorin e ndërtimit.

komuna e xprime

të shfrytëzimit të resurseve minerare disa nga të cilët nuk kanë licenca. Për një dukuri të tillë ka pasur ankesa edhe nga banorët e zonave ku operojnë këtë operatorë por edhe ankesa dhe reagime edhe nga organizatat e shoqërisë civile. Madje ka pasur raportime ku është vlerësuar se këta gurëthyes ndodhen shumë afër vendbanimeve. Tre nga shembujt e këtyre gurëthyesve që kanë qenë pjesë e debateve dhe trajtimit nga organizatat e shoqërisë civile janë një gurëthyes në Carralevë dhe dy gurëthyes në Belincë .

Resurset ujore - Lumi kryesor në territorin e Komunës së Shtimes është lumi Shtime. Ky lum grumbullon edhe ujërat e lumit të Carralevës, Topillës dhe Mollopolcit. Sipërfaqja e pellgut të lumit Shtime është 102 km², me një prurje vjetore prej 32.26 milion m³. Lumi Carraleva buron në malin Carraleva. Ky lum së pari shfaqet pranë “Qafës së Dulës” dhe vazhdon rrjedhën përgjatë luginës së ngushtë të Carralevës. Lugina zgjerohet në zonën nga fshati Belincë deri në Shtime. Ky lumë konsiderohet si një lumë malor, me gjerësi të shtratit të lumit 3-5 m, dhe deri në 7 m përgjatë rrjedhës së poshtme. Thellësia mesatare e këtij lumi është 50 cm dhe në disa pjesë deri në 1 m. Gjatë stinëve të lagësht uji derdhet në shtratin e lumit dhe përmyt zonat përreth. Gjatë sezonit të verës përmban sasi shumë të vogël uji, rreth 40 l / s. Një lumë tjetër me rëndësi që përshkon territorin e komunës është lumi Toplica me gjatësi 14.5 km, nga të cilat 12.9 km ndodhet në territorin e komunës. Burimi i lumit ndodhet në një lartësi mbidetare prej 1200 m. Ujërat nëntokësorë në territorin e kësaj komune mund të gjenden në aluvione dhe sedimente të Neogjenit. Pjesa më e madhe ndodhet përgjatë lumit. Akuiferet bazohen në zall dhe rrë në sedimentet Neogjene, me qëndrueshmëri prej 5-15 m me $K_f = 3,9 \times 10^{-3}$ cm / sek (K_f - koeficienti i filtrimit) dhe debiti 2 - 10,0 l / sek. Rezervat e konsiderueshme të ujërave nëntokësore ndodhen në këto sedimente. Një sasi e vogël uji gjendet në aluvionet e lumit Carraleva dhe në fshatin Pjetershtice, zona e burimit të lumit Drenica. Sipas vlerësimeve të bëra bazuar në hartën hidro-gjeologjike, aluvionet dhe sedimentet ku ndodhen ujërat nëntokësore mbulojnë një sipërfaqe prej 43 km². Sipërfaqja e përgjithshme ujore e komunës përbëhet nga 96.6 ha lumenj, 6.18 ha përrenj 6.18 ha dhe 2.61 ha kanale ujore. Sipërfaqja totale e tokave ujore është 105.39 ha ose 0.78% e territorit të përgjithshëm të komunës .

Pyjet dhe kullosat- Sipërfaqja e tërësishme e pyjeve në Komunën e Shtimes është 6377.8 ha ose 47.4% e sipërfaqes së përgjithshme të komunës. 2926.8 ha ose 45.9 % e pyjeve janë pyje publike, ndërsa 3451 ha ose 54.1% e pyjeve janë në pronësi private. Në shtrirjen e pyjeve ndikim kryesor ka relievi, pasi që i tërë regjioni afër 48% është kodrinoro-malor. Prandaj edhe pyjet në pjesën më të madhe shtrihen në këto sipërfaqe. Dominojnë pyjet e përziera gjetherënëse.

Në komunën e Shtimes ka po ashtu edhe shumë sipërfaqe të zhveshura, që aktualisht e kanë statusin e kullosave. Kjo sipërfaqe mund të planifikohet për pyllëzim, duke rritur kështu sipërfaqen e pyjeve por njëkohësisht do të kishte ndikim pozitiv edhe në parandalimin e e dukurisë së erozionit.

Ndër problemet kryesore mbetet prerja ilegale e pyjeve që është një dukuri shqetësuese dhe që kërkon vëmendje dhe ndërmarrjen e masave nga komuna dhe nga Agjencia e Pyjeve. Kjo dukuri është më e shfaqur sidomos në pyjet që shtrihen rreth vendbanimeve Mollopolc, Devetak, Llanishtë, Petrovë, Topillë, Rancë, Carralevë dhe Zborc.

Në kuadër të përmirësimit të menaxhimit të pyjeve Komuna e Shtimes në bashkëpunim me shoqatat e pronarëve të pyjeve private dhe të Agjencisë së Pyjeve dhe me mbështetje të donatorëve ka pasur disa iniciativa për menaxhimin e përbashkët të pyjeve. Me qëllim të përmirësimit të gjendjes së pyjeve këto iniciativa duhet të përkrahen dhe vazhdojnë edhe në të ardhmen. Po ashtu është e nevojshme që të mbështeten dhe të ngriten kapacitetet e shoqatave të pyjeve private dhe shoqatave dhe grupeve tjera që kanë në fokus të angazhimit të tyre mbrojtjen e pyjeve, natyrës dhe biodiversitetit.

Popullsia

Komuna Shtimes ka popullsi prej 27,324 banorësh, me 4.158 ekonomi familjare, me një dendësi popullsie prej 203.91 banorësh/km² dhe me moshë mesatare 27.62 vjeç. Në bazë të të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, 13,850 banorë janë të gjinisë mashkullore (50.69%), ndërsa 13,474 janë të gjinisë femërore (49.31%). Struktura e popullsisë që jetojnë në vise rurale dhe urbane ka këtë pjesëmarrje: popullsia urbane me 7,255 banorë, ose 26.55% dhe popullsia rurale me 20,069 banorë, ose 73.45%.

Në komunën e Shtimes mesatarja e ekonomive familjare është 6.57 anëtarë për familje. Norma mesatare vjetore e shtimit (nataliteti), sipas vitit 2011, është 536 lindje, ose, shprehur në promilë, 19.61‰. Norma mesatare vjetore e vdekjeve (mortaliteti), sipas vitit 2011, është 85 vdekje, ose shprehur në promilë, 3.11‰. Pra, shtimi natyror për vit, në komunën e Shtimes, është 16.5‰.

Sipas vlerësimit të ASK-së për vitin 2021, Komuna e Shtimes kishte 27,449 banorë, që shënon një rritje prej 0.4% të numrit të banorëve krahasuar me numrin e banorëve në regjistrimin e vitit 2011 (tabela 1). Sa i përket migrimit sipas të dhënave nga ASK, gjatë vitit 2021 në Komunën e Shtimes kishte një migrim prej 825 banorëve, përfshirë migrimet ndërkombëtare dhe ato kombëtare.

Tabela 1: Të dhënat për popullsinë			
Regjistrimi ASK 2011		Vlerësimi ASK 2021	
Numri i populates	Numri i amvisërive	Numri i popullatës	Ngritje / zbritje %
27,324	4,158	27,449	+0.4%

Gjendja e mjedisit dhe e biodiversitetit

Cilësia e ujit sipërfaqësorë (të lumenjëve) në territorin e komunës së Shtimes, monitorohet në dy pika monitoruese, në Devetak dhe në Vojnovc, të cilat ndodhen në lumin Shtime, që i takon pellgut të Ibrit. Në këto pika monitoruese, monitorimi kryhet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK), dhe monitorohen 10 parametra fizikë, 39 parametra kimik dhe 8 metale të rënda. Sipas vlerësimit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), sa i përket parametrave fizik dhe kimik, bazuar në të dhënat e monitorimit në njërin

nga stacionet monitoruese (Devetak), cilësia e ujit nuk është e ndikuar shumë në faktorët e jashtëm nga aktivitet njerëzor dhe cilësia e ujit është shumë e mirë, ndërsa në pikën e dytë monitoruse (Vojnovc) e cila ndodhet pas shkarkimeve të të gjitha ujërave urbane nga të gjitha fshatrat për rreth dhe të vetë qytetit të Shtimes, cilësia e ujit të këtij lumi është e dobët.

Në këtë gjendje ka ndikuar shkarkimi i ujërave nga aktivitetet e ndryshme prodhuese, urbanizimi dhe bujqësia. Presionet në ujëra vijnë kryesisht si pasojë e rritjes së vëllimit të ujërave të shkarkuara pa trajtimin adekuat fizik, kimik e biologjik. E gjithë kjo ndikon në rritjen e vlerave të parametrave fizikë, kimik dhe mikrobiologjik në trupat ujqorë. Presione të tjera nga reshjet janë shpëlarja e tokave bujqësore dhe sipërfaqeve të tjera ndotëse me ç'rast vije deri te rritja e materieve të suspenduara, materieve inorganike dhe atyre organike. Edhe sa i përket monitorimit të metave të rënda, janë regjistruar tejkalime të vlerave të lejuara për kromin, manganin dhe hekurin në pikën monitoruese në Vojnovc. Vlerësohet që tejkalimi i këtyre parametrave është rezultat i shkarkimeve në trupin ujqorë të ujërave nga aktivitetet e ndryshme prodhuese dhe industriale në këtë zonë.

Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujqore dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve, ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve ujqore në territorin e Komunës së Shtimes. Burim i ndotjes së lumenjëve në komunën e Shtimes, janë mbeturinat që hidhen në këta lumenjë dhe derdhja e ujërave të zeza direkt në lumenjë pa ndonjë trajtim paraprak.

Cilësia e ajrit- Në komunën e Shtimes, nuk ka ndonjë stacion nacional apo lokal të monitorimit të cilësisë së ajrit, prandaj nuk ka të dhëna të cilave mundë ti referohemi për të vlerësuar cilësinë e ajrit në këtë komunë. Por nëse marrim për bazë të dhënat nga stacionet tjera dhe ngjashmëritë që ka komuna e Shtimes me lokalitetet tjera ku behët monitorimi i ajrit, vlerësohet dhe pritët që problemi kryesor të jetë ndotja me grimcat PM10 dhe PM 2.5. Komuna e Shtimes, nuk ka ndonjë industri të zhvilluar që do të ishte burim i ndotjes së ajrit. Andaj burimet kryesore të ndotjes së ajrit janë ekonomitë familjare, institucionet publike që përdorin lëndë djegëse për ngrohje, transporti dhe operatorët e shfrytëzimit të gurit.

Në komunën e Shtimes vlerësohet se janë 2903 ekonomi familjare që e përdorin drurin si lëndë djegëse. Konsumi vjetor i drurit vlerësohet të jetë 28.901 m³ dru. Mesatarja vjetore e sasisë së drurit të përdorur nga ekonomitë familjare për ngrohje është 9.33 m³.

Në ndërtesat publike të komunës së Shtimes në kuadër të pjesëmarrjes së burimeve energjetike që përdoren për ngrohje dominon druri me 2.184 m³ dhe 2500l naftë. Gjatë vitit 2018 dhe 2019, në ndërtesat publike të komunës së Shtimes nuk është përdorur thëngjilli për shkak të ndalimit të përdorimit të tij nga Ministria e Mjedisit. Një kalkulim i përafërt i emetimeve totale vjetore të ndotësve të ajrit sipas sektorëve është prezantuar në tabelën 2. Nga tabela shihet se burimet kryesore të ndotjes së ajrit janë emetimet nga djegjet e vogla (amvisëria, shërbimet dhe institucionet) dhe trafiku.

Tabela 2: Emetimet totale vjetore të emisioneve në ajër në komunën e Shtimes sipas sektorëve dhe ndotësve ton/vit					
	Djegjet e vogla (amvisëria, shërbimet, ndërtesat publike)	Trafiku	Bujqësia	Gurëthyesit	Gjithsej
Grimcat e pluhurit PM10	322	61	23	23	429
Grimcat e pluhurit PM2.5	314	28	3	5	350
Oksidet e Azotit (NOX)	31	220	80	0	331
Dyoksidi i Sulfurit (SO2)	66	0,1	0	0	66
Monoksidi i Karbonit (CO)	1869	105	6	0	1980

Ndotja nga zhurma - Trafiku rrugor dhe aktivitetet ekonomike konsiderohen burimet kryesore të zhurmës në Komunën e Shtimes edhe pse aktualisht nuk ka ndonjë matje të organizuar të nivelit të zhurmës në komunë. Në mënyrë të veçantë këto burime të zhurmës intensifikohen gjatë zbatimit të aktiviteteve të ndryshme sikurse janë aktivitetet e ndërtimit, transporti i mallrave, gurëthyesit, përdorimi i pajisjeve industriale e tjera. Komuna e Shtimes duhet të ketë për bazë që zhurma është një nga ndotësit e mjedisit dhe matja e nivelit të saj është e nevojshme për të vlerësuar nivelin e ekspozimit të popullatës ndaj këtij ndotësi. Kjo është edhe kërkesë ligjore që del nga Ligji për mbrojtje nga zhurma Nr. 02/L-102.

Ndotja e tokës- Një ndër burimet kryesore të ndotjes së tokës janë edhe industritë kimike, përdorimi jo racional i pesticideve dhe plehrave jo minerale, ndotja e tokës me materie radioaktive, ndotja e tokës me metale toksike si dhe ndotja e tokës me mikro organizma patogjen. Gjithashtu edhe humbja e shtresës cilësore të tokës nga procese natyrore të erozionit si dhe nga aktivitetet e njeriut sikurse është prerja e pakontrolluar e pyjeve konsiderohet si ndër faktorët kryesor të degradimit të tokave. Në Kosovë ende nuk ka sistem të monitorimit të tokës (dheut). Në mungesë të të dhënave nga monitorimi i tokës/dheut, është e vështirë të bëhet një vlerësim i besueshëm. Megjithatë ky problem është adresuar përmes projekteve specifike. Një nga këto projekte ka qenë projekti i financuar nga Bashkimi Evropian (BE) për studimin e tokës bujqësore në Kosovë (ALPS-Agriculture Land Pollution Survey). Qëllimi kryesor i projektit ka qenë të bëjë vlerësimin e ndotjes së tokës bujqësore. Në kuadër të projektit janë analizuar mostrat toke për 17 metale të rënda, mostra toke për treguesit e pjellorisë, mostra toke për përmbajtjen e ndotësve organik dhe mostra bime për metale të rënda. Vlerësimi i ndotjes së tokës ka qenë i orientuar në zonat potenciale të ndotjes si: zonat industriale, uji i ndotur dhe mbetjet, përmbajtjet, aktivitetet bujqësore etj.

Në kuadër të rezultateve kyçe të projektit thuhet se: përqendrimet e metaleve të rënda (Zn, Cu, Cr, Ni, Cd, Pb, Hg, Zn, Cu, si dhe Ni) janë brenda standardeve të ndotjes së tokës dhe se nuk është identifikuar ndotja e të lashtave (perime, drithëra dhe fruta), nga metalet e rënda (në veçanti Cr, Ni, Pb, Zn,), prej mostrave të tokës për qëllime bujqësore.

Eksplotimi i resurseve minerare është një dukuri tjetër, e dëmtimit të tokës në komunën e Shtimes. Në bazë të të dhënave të Komisionit të Pavaruar të Minierave dhe Mineraleve, në

territorin e komunës së Shtimes operojnë 53 operatorë që si subjekt të veprimtarisë kanë eksploatimin e gurit dhe të rërës. Nga këta operatorë 25 operatorë që kanë licenca për veprimtarinë e tyre dhe 9 operatorë që nuk kanë licenca për veprimtarinë e tyre¹. Faktorët tjerë që dëmtojnë cilësinë e tokave në Shtime janë edhe: ndërtimet e paplanifikuara, erozioni, dhe përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve.

Zonat e Mbrojtura - Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) në bashkëpunim me Komunën e Shtimes, kanë evidentuar edhe disa zona të rëndësishme të natyrës në territorin e komunës. Në kuadër të listës së zonave të mbrojtura të natyrës në Komunën e Shtimes, padyshim se Shpella e Pjetërshticës, Shpella e Devetakut dhe Kompleksi i pishave të Shtimes, paraqesin zonat me të rëndësishme. **Shpella e Pjetërshticës** ndodhet në fshatin Pjetërshticë në kodrën e quajtur Suka e Vogël. Është një shpellë ende e pahulumtuar sa duhet e cila sipas disa veçorive është e ngjashme me Shpellën e mermertë në Gadime. Shpella ka pamje shumë të bukur me plot kristale dhe shkëlqim, duke filluar nga hyrja. Shpella e Pjetërshticës është marrë në mbrojtje nga Asambleja e Komunës së Shtimes në vitin 2017. **Shpella e Devetakut**, është një tjetër vlerë natyrore e Komunës së Shtimes. Ajo u zbuluar rastësisht në vitin 2013, nga një i ri derisa po gërmonte me ekskavator për të nxjerrë gurë. Ndodhet në fshatin Topillë, disa metra mbi vendin Vrella e Zezë. Shpella ka hyrje natyrore, një korridor që vazhdon me gjatësi rreth 20 metra, derisa pjesa pas tyre ka një ngushticë, e cila nuk është eksploruar ende. Territori i fshatit Topillë njihet edhe për shpella të tjera, ndërsa zbulimi i kësaj shpelle paraqet një risi për këtë komunë, dhe pritet që në të ardhmen pritët të përgaditet edhe për hapje për vizitorë. Hapësira në të cilën është gjetur shpella, përkatësisht rruga prej Gurit të Shtrenjtë deri në fshatin Topillë, është e njohur edhe për atraksione të tjera, siç është Shpella e Imer Devetakut, Kështjella Mesjetare e Topillës, Shpella e Lakuriqëve, e njohur edhe si Shpella e Topillës.

Flora - Në pjesën malore dominojnë pyjet përziera. Prej drunjëve dallohen llojet gjetherënëse si qarri (*Quercus cerris*), bungu, ahu (*Fagus sylvatica*), shkoza (*Carpinus orientalis*). Përhapje më të kufizuar kanë llojet tjera që paraqiten si të vetmuara si brekia, bliri (*Tilia kordata*), frashëri etj. Përhapje kanë edhe llojet drunore të shkureve si thana (*Cornus mas*), murrizi (*Crataegus monogyna*), kaça (*Rosa canina*), manaferra e egër (*Rubus fruticosus*), shtogu (*Sambucus nigra*), kulumbria (*Prunus spicosa*), lajthia (*Corylus avellana*), në vise të larta fieri i shqiponjës (*Pteridium aquilinum*) etj. Prej bimëve barishtore, ka lloje të ndryshme si ato që rriten në ambient të hapur pa prezencë të drunjëve, si edhe, ato që rriten brenda pyjeve. Me rëndësi të veçantë janë llojet bimore barishtore aromatike si çaji i malit (*Origanum vulgare*), kantarioni (*Hypericum perforatum*), kamomili (*Matricaria chamomila*), dredhëza (*Fragaria vesca*) etj.

Fauna- Si rezultat i aktiviteteve antropogjen e sidomos ato gjatë shndërrimit të hapësirës natyrore në territor agrikulturor, industrial apo territor për banim disa lloje shtazore të cilat

¹ Burimi i informacionit: <http://opendata.cohu.org/sq/degradimi-mjedisit>

kanë ekzistuar në këto zona janë zhdukur ose zhduken. Lloje të cilat janë zhdukur kohë më parë nga këto terrene janë: dreri, dhia e egër, pulelegra etj. Llojet prezente janë më rezistente ndaj kushteve të ofruara apo të imponuara por edhe te këto lloje vërehet zvogëlimi i numrit të tyre. Llojet të cilat ende hasen në territorin e Shtimes janë: ariu (*Ursus arctos*), ujku (*Canis lupus*), dhelpra (*Vulpes vulpes*), qelbësi i rëndomtë, derri i egër (*Sus scrofa*), vjedulla (*Meles meles*), ketri (*Sciurus vulgaris*), sqarhi (*Martes foina*), vidra, lepuri (*Oryctolagus cuniculus*), disa lloje të brejtësve të vegjël, gjeraqina, skifteri i përhimtë, petriti (*Falco tinnunculus*), kukuvajka, huti (*Bubo bubo*), harabeli, thëllënza (*Alectoris graeca*), pëllumbi i egër, kumria, disa lloje të korbave, çukapiku (*Dendrocopus major*), qyqja (*Cuculus canorus*), lauresha, borësi, rosat e egra (*Anser anser*), patat e egra (*Anas platyrhynchos*), lejlekët (lloje kalimtare dhe hasen rrallë), breshka e kënetave, breshka e pyjeve, hardhuca e përhimë, hardhuca e mureve, hardhuca e gjelbër, neperka, gjarpëri i larmë, gjarpëri i ujit (johelmues), picrraku (*Salamandra atra*), tritoni (*Triturus vulgaris*), bretkosa e gjelbërt, bretkosa dregëzore, krapu (*Cyprinus caprio*), fildishi, skobusi, shumë lloje të pakurrizorëve etj.

Të dhënat mbi ekonominë lokale

Në komunën e Shtimes aktivitetin e zhvillojnë 1878 biznese të regjistruara². Dominojnë bizneset që fushëveprimtari të tyre kanë tregtinë (685), prodhimin (203), transportin (198) akomodimin dhe shërbime ushqimi (186), ndërtimtari (180) dhe sektorin e bujqësisë (117). Struktura sektoriale e këtyre veprimtarive është prezantur në tabelën 3. Numri më i madh i aktiviteteve të bizneseve është i përqendruar në vendbanimet përgjatë rrugëve magjistrale, por edhe në vendbanimet e tjera, ku kanë infrastrukturë të përshtatshme.

Tabela 3: Numri i bizneseve të komunës së Shtimes sipas llojit të veprimtarisë		
Nr.	Lloji i veprimtarisë së bizneseve	Numri i bizneseve
1	Bujqësi, Pylltari dhe Peshkatari	117
2	Xehetari dhe gurëthyes	21
3	Prodhim	203
4	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	4
5	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete të rivitalizimit	7
6	Ndërtimtari	180
7	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	685
8	Transport dhe ruajtje	198
9	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	186
10	Informacion dhe komunikim	28
11	Aktivitete financiare dhe siguri	4
12	Aktivitete të patundshmërisë	3
13	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	37
14	Aktivitete administrati-ve dhe mbështetëse	19

²Komuna e Shtimes,, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave 2022-2026

16	Arsim	16
17	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	26
18	Art, zbavitje dhe rekreacion	37
19	Aktivitetet të shërbimeve të tjera	107
Gjithsej		1878

Zona Ekonomike në Shtime gjendet në kilometrin e dytë në rrugën magjistrale Shtime - Ferizaj (M-25.3). Zona përfshin një sipërfaqe prej 10.7ha. Në Parkun Teknologjik në Shtime janë të vendosura 12 biznese, 7 prej tyre kanë filluar veprimtarinë, kurse 5 biznese janë në fazën e investimeve kapitale. Numri i të punësuarve në Parkun Teknologjik është 105, në vitin 2018 dhe deri në vitin 2020 numri i të punësuarve do të rritet në 160. Bazuar në planet e biznesit në Parkun Teknologjik do të punësohen 217 punëtorë të rregullt dhe ofro 100 sezonalë, ndërsa vlera e planifikuar e investimeve është 9,968,200€.

Bujqësia

Komuna e Shtimes e ka në traditën e saj marrjen me bujqësi³, veçanërisht kultivimin e drithërave të bardha si grurin, misrin, thekrën, tërshërën dhe disa kultura të pemëve frutore: faroret, bërthamoret dhe aroret si dhe pemë të imta: dredhëza, mjedra, kultura perimore në ambiente të mbyllura dhe ambient të hapur: specat, domate, tranguj, lakra etj, si rrjedhojë e sipërfaqes së madhe të tokës bujqësore, por edhe të burimeve të mëdha ujore dhe kapaciteteve njerëzore që zotëron.

Sipas regjistrimit të bujqësisë të realizuar në vitin 2014 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komuna e Shtimes ka 2516 ekonomi bujqësore, 6128 hektarë tokë bujqësore dhe 4352 njësi blegtorale. Sa i përket fondit blegtoral, dominojnë gjedhet me 3863 krerë, delet me 1430 krerë dhe dhitë me 424 krerë. Në territorin e komunës operojnë 21 ferma për prodhimin e qumështit, 5 ferma për trashjen e viçave, 12 ferma të deleve, dhe 4 ferma të dhive.

Po ashtu janë aktive 5 ferma të pulave për prodhimin e vezëve, me mbi 30,000 pula vojse dhe një fermë për prodhimin e zogjve për konsum me kapacitet prej 3600 zogj, ndërsa që numri total i pulave në territori në komunë konsiderohet të jetë 70.000 pula. Gjatë viteve të fundit një zhvillim të veçantë ka marrë edhe rritja dhe kultivimi i bletës, ku sipas të dhënave janë aktiv 49 bletarë me gjithsej 2884 shoqëri bletësh. Sa i përket kultivimit të kulturave bujqësore dominojnë drithërat e në veçanti gruri dhe misri. Sipërfaqja e përgjithshme e perimeve është 72 ha, nga të cilat mbi 8.5 ha janë serra. Sipërfaqe me pemishte në komunën e Shtimes sipas regjistrimit të bujqësisë janë rreth 45 ha, nga të cilat 32 ha mollë, 6 ha kumbull, 3.3 ha lajthi, 1.5 ha dardhë dhe rreth 2.5 ha pemishte tjera (ftua, arrë, qershi etj.) Rreth 88 ha të sipërfaqes së tokave bujqësore në komunën e Shtimes është e përfshirë në sistemet e ujitjes. Që nga viti 2014 në Parkun Teknologjik operon Qendra e Agrobiznesit, e cila tregton pemë dhe perime brenda dhe jashtë Kosovës.

³Komuna e Shtimes, Sektori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Turizmi lokal

Në komunën e Shtimes janë të shpallura 3 zona turistike, Llanisht- Topillë, Rancë-Carralevë dhe Dugë. Vlera më e madhe në turizëm është pjesa malore, e cila gjendet në perëndim të qytetit, në fshatrat Mollopolc, Devetak, Llanisht, Topillë, Rancë, Carralevë dhe Dugë. Në këto vargmale ka peizazhe natyrore shumë të bukura. Në këto zona gjenden mbi 200 burime të ujit, po ashtu atraksion i veçant janë Shpella e Imer Devetakut dhe Shpella e Lakuriqëve. Është shpallur edhe zona turistike Mollopolc-Devetak, e cila ka bukur natyrore, në veçanti ujëvara e Mollopolcit, mbi 90 burime të ujit, lumi dhe pyjet e bukura.

Një zonë tjetër rekreative që ndodhet afër qytetit të Shtimes, është parku i pishave, që po ashtu ka edhe statusin e zonës së mbrojtur të natyrës me sipërfaqe rreth 15 ha.

Potenciale tjera për zhvillimin e turizmit në Komunën e Shtimes janë edhe objektet e trashëgimisë kulturore, natyrore dhe historike që ndodhen në territorin e komunës ndër të cilat duhet veçuar: Kështjella mesjetare e Topillës, Kalaja e Petrovës, Kulla e Agush Agës, Tyrbja e Shtimes, Vendlindja e Ahmet Shtimes, Xhamia e Vjetër e Shtimes, Xhamia e Rashincës Xhamia e Carralevës, Kulla e Muhamet Begut, Kulla e Sherif Agës në Vojnovc, Kulla e Ramë Sylës së Vojnovcit, Kulla e Sahitit në Carralevë, Shkolla e Parë në Shtime, Shtëpia e Përshpirtshme, Kisha Ortodokse e Mihail Arkangjelit të Shenjtë, Shpella e Pjetërshticës, Shpella e Imer Devetakut - Devetakë, Gryka e Llanishtit, Kompleksi Përkujtimor "Masakra e Reçakut" – Reçak etj.

Në territorin e Komunës janë 13 objekte akomodimi dhe rekreacioni (motele, pishina, restaurante) që ofrojnë qëndrim dhe akomodim 24 orë dhe që kanë në dispozicion 70 dhoma dhe 80 shtretër. Numri mesatarë i vizitorëve për një muaj llogaritet të jetë 350⁴.

Komuna e Shtimes ka përgaditur dhe miratuar Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit Rural 2015-2019, që tani duhet të rishikohet dhe plotësohet. Objektivat kryesore të kësaj strategjie janë: ngritjen e vetëdijes dhe njohjen e rëndësisë së turizmit rural për zhvillim dhe ndikim pozitivë në ekonominë lokale, përmirësimi i kushteve dhe cilësisë së jetës së banorëve të zonës o Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit rural dhe rritja e punësimit dhe krijimi i mjedisit të favorshëm për investime dhe stimulimin e bashkëpunimit mes sektorëve publik dhe privat (PPP).

Arsimi

Struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Shtimes është e organizuar në katër nivele: arsimin parashkollor (5 - 6 vjeçar), arsimin fillor (I – V), arsimin e mesëm të ulët (VI – IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (X – XII). Procesin edukativo-arsimor, nga ai parashkollor, deri në shkollimin e mesëm të lartë, e ndjekin 5987 nxënës, të cilët kanë në dispozicion një institucion parashkollor, shtatë shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, me 10 paralele të ndara, një gjimnaz si dhe një shkollë të mesme profesionale (tabela 4). Në procesin arsimor janë të angazhuar 436 punëtorë. Prej tyre 370 mësimdhënës, 66 në stafin administrativ dhe teknik.

⁴ Strategjia e Zhvillimit të Turizmit Rural në Komunën e Shtimes 2015-2019

Tabela 4: Struktura e institucioneve arsimore dhe e nxënësve	
Institucionet arsimore	Gjithsej
Institucioni parashkollor – çerdhja	131
Arsimi parafillor 5 - 6 vjeç	340
Arsimi fillor (1 - 5)	2011
Arsimi i mesëm i ulët (6 - 9)	1579
Gjimnazi (10 - 12)	1044
Gjithsej	5105

Shkolla speciale – në zonën urbane gjendet shkolla speciale për persona me aftësi të kufizuara. Në këtë shkollë janë gjithsej 8 nxënës, dy mësime të kualifikuara, 1 person staf teknik dhe një udhëheqës-se. Hapësira shkollore e kësaj shkolle është 130 m² ose 16.25 m² hapësirë e brendshme shkollore për një nxënës. Kjo shkollë ka kushte të konsiderueshme për ndjekjen e mësimave.

Shëndetësia

Kujdesi shëndetësor në komunën e Shtimes është i organizuar dhe ofrohet përmes sektorit publik shëndetësor dhe atij privat. Komunat janë përgjegjëse për kujdesin parësor shëndetësor publik dhe për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e tyre. Kujdesi primar shëndetësor publik ofrohet përmes: Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF “Dr Vezir Bajrami” në Shtime dhe katër Qendrave të Mjekësisë Familjare në fshatrat: Muzeqinë, Pjetërshticë, Petrovë dhe Godanc. Veprimtari e QKMF-së është ofrimi i shërbimit parësor shëndetësor për qytetarët e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë shoqëror, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës. Totali i të punësuarve në sektorin e shëndetësisë në Komunën e Shtimes është 74 të punësuar (tabela 5).

Tabela 5: Numri dhe pozitat e të punësuarave në QKMF të Shtimes	
Pozitat	Numri
Mjek përgjithshëm	12
Specialistë	2
Pulmolog	1
Gjinekolog	1
Dentist	3
Radiolog	1
Infermier	50
Laboranta	5
Staf ndihmës /administratë, pastrim, arkivim, vozitës.	13
Gjithsej	88

Administrata publike

Organet komunale janë: Kuvendi që është organi më i lartë në komunë dhe Kryetari që kryen udhëheqjen komunale të ekzekutivit. Në kuadër të administratës funksinojnë 6 drejtori me 168 të punësuar (figura 2).

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në administratën e Komunës së Shtimes është 168 duke mos përfshirë këtu edhe të punësuarit në sektorin e arsimit. Së bashku me këtë sektorë numri i përgjithshëm i të punësuarve në Shtime është 646 të punësuar (tabela 6).

Tabela 6: Numri i të punësuarve në administratën e Komunës së Shtimes	
Sektorët	Numri i të punësuarve
Pozita politike	15
Shërbyes civil / staf mbështetës	94
QPS – Shërbyes civil	10
Gjithsej	119




Figura 2. Struktura organizative e komunës së Shtimes

Dokumentet relevante komunale

Në tabelën 7 janë prezantuar dokumentet relevante komunale që ndërlidhen me menaxhimin e mbeturinave dhe afati i zbatimit të tyre.

Tabela 7: Dokumentet relevante komunale, afati i zbatimit të tyre dhe ndërlidhja me menaxhimin e mbeturinave	
Dokumenti	Qëllimi dhe fushëveprimi
Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Shtimes 2010-2020	Është bazë për zhvillim të qëndrueshëm në komunën e Shtimes, dhe synon ruajtjen e mjedisit, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve për zhvillim ekonomik, për gjeneratat e ardhshme dhe balancimin e zhvillimeve hapësinore. Përmes këtij plani koordinohen kërkesat sociale dhe ekonomike për hapësirën me funksionet e saj kulturore dhe ekologjike.
Plani Rregullues Urban i Komunës së Shtimes	Qëllimi i këtij plani është që të organizojë ndërtimet në pjesën urbane të qytetit që është edhe pjesa identifikuese e komunës së Shtimes.
Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Shtimes 2019-2022	Paraqet synimet strategjike zhvillimore socioekonomike me impakt afatmesëm në zhvillimin ekonomik lokal të Komunës së Shtimes. Në mënyrë të veçantë Qëllimi 6, i këtij dokumenti është i fokusuar në përmirësimin dhe ruajtjen e mjedisit.
Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2021-2025	Dokument planifikues - strategjik, që adreson zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal për periudhën 5 vjeçare. Në një kapitull të veçantë ky dokument trajton edhe aspektet e menaxhimit të mbeturinave. Në kuadër të këtij kapitulli janë përcaktuar objektiva dhe aktivitete specifike për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave komunale.
Plani për Mirëmbajtjen e Hapësirave Publike në Komunën e Shtimes	Në planin e mirëmbajtjes së hapësirave publike të Komunës së Shtimes janë përfshirë aktivitetet për mirëmbajtjen e parqeve, shesheve dhe hapësirave tjera publike të komunës.
Plani për Investime të Hapësirave të Hapura Publike në Komunën e Shtimes 2016-2021	Plani Investiv ka për qëllim të përcaktojë investimet e orientuara në hapësirat publike për komunën e Shtimes sipas parashikimeve të përcaktuara gjatë hartimit të Planit për Mirëmbajtjen e Hapësirave Publike në Komunën e Shtimes.

1.5. Të dhënat për mbeturina në komunë

Gjenerimi dhe kompozicioni i mbeturinave:

Në komunën e Shtimes nuk ka ndonjë analizë për kompozicionin e mbeturinave në territorin e kësaj komune. Pjesa e kompozicionit të mbeturinave është bazuar në të dhënat e komunës së Ferizajt, ndërsa sasia e mbeturinave të gjeneruara është vlerësuar duke u bazuar në sasinë e mbeturinave të gjeneruara për kokë banori.

Tabela 8: Bilanci i mbeturinave komunale

Kategoria	Mënyra e përcaktimit të sasisë	Mbeturinat e grumbulluara			Mbeturinat e dorëzuara		
		Nga operatorët e grumbullimit	Nga ricikluesit	Nga deponitë ilegale	Mbeturinat e ricikluara	Mbeturinat e tregtuara	Mbeturinat e deponuara
Letër dhe karton	14.1%	1,328.5	NA	NA	NA	NA	1,328.5
Qelq	3.5%	216.3	NA	NA	NA	NA	216.3
Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat	34.1%	2,107.1	NA	NA	NA	NA	2,107.1
Tekstil dhe veshjet	7.4%	457.3	NA	NA	NA	NA	457.3
Pllastika	20.9%	1,291.5	NA	NA	NA	NA	1,291.5
Metal	1.8%	111.2	NA	NA	NA	NA	111.2
Mbeturina mikse komunale	10.8%	667.4	NA	NA	NA	NA	667.4
Mbeturinat tjera komunale ⁵	100%	5,788.5	NA	NA	NA	NA	5,788.5

1.6. Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Operatorët e shërbimit të grumbullimit dhe transportit

Në komunën e Shtimes, organizmi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave bëhet në kuadër të kompanisë regjionale të mbeturinave KRM "Pastërtia", njësia në Shtime. Mbulimi i zonës, e shprehur në përqindje 73.1%⁶ prej amvisërive.

Tabela 9: Operatorët e mbeturinave nën përgjegjësi komunale

	Emri i operatorit (biznesit)	Forma e pronësisë	Kategoria e menaxhimit të mbeturinave	Mbulimi me shërbim %	Statusi i kontraktimit (po/jo)
Operatori 1	KRM "Pastërtia"	Publike	Komunale	73.1%	Po

Mbulimi me shërbim:

Sipas të dhënave nga Raporti për menaxhimin e mbeturinave komunale 2021, mbulushmëria me shërbimin për grumbullimin e mbeturinave për ekonomi familjare në vitin 2021 ishte 73%, që shënon një progres prej 3%, me vitin paraprak. Shërbimi për grumbullimin e mbeturinave ofrohen 100% për institucione dhe për 301 biznese (Tabela 10).

⁵ Mbeturinat bio-degraduese nga parqet, mbeturinat nga tregjet, etj.

⁶ Raporti për menaxhimin e mbeturinave komunale 2021, AMMK 2022

Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave 2022-2026

Tabela 10: Mbulimi me shërbim në territorin e komunës⁷

Emri i operatorit	Numri i EF	Numri i EF të shërbyera	Numri i bizneseve aktive	Numri i bizneseve të shërbyera	Numri i institucioneve	Numri i institucioneve të shërbyera
KRM "Pastërtia"	4158	3109	NA	301	28	28

Tabela 11 prezanton, mbulimin me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave sipas vendbanimeve. Në komunën e Shtimes, ende nuk ofrohet shërbimi për ndarjen e mbeturinave në burim.

Tabela 11: Mbulimi i ofrimit të shërbimit për EF sipas vendbanimit

Nr.	Vendbanimi	Numri i EF	Numri EF të shërbyera	Mbulimi me shërbim %	Numri EF me ndarje në burim	EF me ndarje në burim %	Lloji i ndarjes së mbeturinave ⁸
1.	Shtime						
2.	Belinc						
3.	Carraleve						
4.	Davidovc						
5.	Gllavice						
6.	Godanc I Eperm						
7.	Godan I Poshtem						
8.	Gjyrkoc						
9.	Mollopolc						
10.	Muzejine						
11.	Petrove						
12.	Petroviq						
13.	Pjetershtice						
14.	Rashince						
15.	Reqak						
16.	Vojnovc						
17.	Zborc						

⁷ Raporti për menaxhimin e mbeturinave komunale 2021, AMMK 2022

⁸ Spjego infrastrukturën ndarëse të EF, psh., pajisje me komposter individual, sistem me dy shporta (riciklueshme të pareciklueshme)

Tipologjia e ofrimit të shërbimit:

Në tabelën 12 janë prezantuar të dhënat për ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në zonën e shërbimit të ndarë në tre seksione: zona urbane qendra, zona periurbane dhe zona rurale. Gjithashtu tabela ofro të dhëna edhe mbi tipologjinë e ofrimit të shërbimit dhe frekuencën e shërbimit.

Tabela 12: Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit

Vendbanimi	EF të shërbyera derë më derë %	Frekuenca e shërbimit	EF të shërbyera me shporta / kontejnerë të përbashkët %	Frekuenca e shërbimit
Zona urbane qendra ⁹				
Zona periurbane ¹⁰				
Zona rurale				

Asetet e hudhjes, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale:

Tabela 13, ofron të dhënat për asetet e njësisë së KRM “Pastërtia” në Shtime për hudhejn dhe grumbullimin e mbeturinave dhe gjendjen teknike të tyre.

Tabela 13: Pajisjet për hudhjen dhe grumbullimin e mbeturinave

Lloji i kontejnerit	Numri	Gjendje të mire %	Gjendje funksionale %	Gjendje jo të mire %
Shporta 120 l	2600	2600	2600	0
Shporta 240 l	0	0	0	0
Kontejnerë 1.1 m3 metalik	260	260	260	0
Kontejnerë 1.1 m3 plastikë	0	0	0	0
Kontejnerë 5.1 m3	0	0	0	0
Kontejnerë 7.1 m3	0	0	0	0
Kontejnerë 30 m3 – Transfer	0	0	0	0

Në tabelën 14 janë prezantuar të dhënat për asetet njësisë së KRM “Pastërtia”, në Shtime për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave.

Tabela 14: Pajisjet për grumbullim dhe transport të mbeturinave

Brendi	Tipi	Kapaciteti ton apo m3	Viti i prodhimit	Targat	Gjendja (e mirë /funksionale/e keqe)
Kamion	Mercedes	8.4T	1991	05-793-CK	E keqe
Kamion	Man	10.6T	2006	01-362-OA	E mire
Kamion	Shen Hu	2.6T	2011	06-158-AP	E keqe
Kamion	Mercedes	5.3T	2022	05-692-GG	E mire

⁹ Ndërtesa shumëkatëshe me banim kolektiv

¹⁰ Banim rezidenciale me shtëpi individuale

Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave 2022-2026

Kamion	Isuzi	5.0T	2021	05-208-GJ	E mire
Kamion	Isuzi	5.0T	2021	05-209-GJ	E mire
Traktor	IMT 539	1.5T	2000		E mire
Traktor	IMT 539	1.5T	1995		E mire
Traktor	IMT 539	1.5T	1990		E mire

1.7. Rishikimi i implementimit të planit

Në kuadër të procesit të hartimit të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2022-2026, komuna e Shtimes ka bërë edhe vlerësimin e implementimit të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2016-2021.

Komuna ka bërë një analizë të realizimit të objektivave të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2016-2021, me qëllim që të ketë një pasqyrë më të qartë për hartimin e objektivave të rinjë dhe caktimin e caqeve të performancës për periudhën e ardhshme pesëvjeçare.

Në tabelën në vijim janë listuar objektivat e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2016-2021, treguesit e suksesit, caqet e planifikuara, realizimin e tyre.

Sipas tabelës ku janë prezantuar 8 objektiva kryesore të planifikuara, disa prej tyre janë realizuar në shumë mirë ose kënaqshëm, kurse disa të tjera janë realizuar në nivel jo të mirë ose jo kënaqshëm. Arsyet për nivelin e ulët të zbatimit të këtyre objektivave ndërlidhen me mungesën e buxhetit, mungesën e mbështetjes dhe mungesën e kapaciteteve të komunës për realizimin e këtyre objektivave.

Për më shumë detaje referojuni tabelës: Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM 2016-2021.

Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave 2022-2026

Tabela 15: Përfundimi dhe realizimi i objektivave të PKMM aktual

Objekti dhe MM	Treguesi i performances	Gjendja fillestare	Caku	Realizimi	Koment
Rritja e mbeturinave me përshirje të gjitha amvisërive, shërbimeve dhe institucionet dhe bizneset me shërbim	Përfshirja e të gjitha të amvisërive, shërbimeve dhe institucionet dhe bizneset me shërbim	40% e amvisërive, 90% e institucionet dhe bizneset te mbulura me shërbim		74% e amvisërive, institucionet dhe bizneset te mbuluara me shërbim	Mungesa e kapaciteteve teknike dhe financiare
O1					
Shtimi i mbeturinave në Krijimi i sistemit për ndarje dhe mbeturinave në burim i shkollat publike ndarja e mbeturinave në burim në shkollat publike dhe institucionet lokale të komunës dhe Shtimes		Asnje nga shkollat publike dhe institucionet në nivel lokal nuk ka institucionet në nivel sistem për ndarjen e mbeturinave	100 % e shkollave publike dhe institucionet në nivel lokal nuk ka institucionet në nivel sistem për ndarjen e mbeturinave	Nuk është realizuar	Mungesa e kapaciteteve teknike dhe financiare
O2					
Krijimi i sistemit lokal të kompostimit	Fillimi i procesit të kompostimit familjare	Asnje ekonomi familjare nuk ka kompostera familjare	Paisja e 80 familjeve me komposter familjare	Xx ekonomi familjare janë pajisur me komposter familjare	Mungesa e kapaciteteve teknike dhe financiare
O3					
Grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave	Fillimi i procesit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave shtazore.	Komuna nuk ka kompani kontraktuar për grumbullim dhe transportit të mbeturinave shtazore.	Kontraktimi i një kompanie për grumbullim dhe transportit të mbeturinave shtazore.	Komuna nuk ka arritur të kontrakttoj një kompanie për grumbullim dhe transportit të mbeturinave shtazore	Mungesa e kapaciteteve teknike dhe financiare
O4					
Ndarja e mbeturinave medicinale nga mbeturinat komunale	Fillimi i procesit të ndarjes së mbeturinave medicinale nga mbeturinat komunale	Komuna nuk ka sistem të ndarjes së mbeturinave medicinale nga mbeturinat komunale	Te funksionalizohet sistemi i ndarjes së mbeturinave medicinale nga mbeturinat komunale	Komuna nuk ka arritur të funksionalizoj sistemin e ndarjes së mbeturinave medicinale nga mbeturinat komunale	Mungesa e kapaciteteve teknike dhe financiare
O5					
Identifikimi i lokacionit për ndërtimin e qendrës grumbulluese për mbeturinat nga ndërtimi i pecaktuar	Lokacioni për ndërtimin e qendrës grumbulluese për mbeturinat nga ndërtimi i pecaktuar	Komuna nuk ka pas te pecaktuar një lokacion për ndërtimin e qendrës grumbulluese për mbeturinat nga ndërtimi i pecaktuar	Funksionalizimi i qendrës grumbulluese për mbeturinat nga ndërtimi i pecaktuar	Lokacioni është pecaktuar Qendra grumbullimit	Mungesa e kapaciteteve teknike dhe financiare
O6					

Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave 2022-2026

O7 Reforme administrative	Rregullorja menaxhimin mbeturinave e miratuar nga kuvendi i komunës	mbeturinat nga ndërtimi i pecaktuar	ndërtimi në kontratë me kompani private	mbeturinave nuk është funksionalizuar
O7 Reforme administrative	Rregullorja menaxhimin mbeturinave e miratuar nga kuvendi i komunës	Veprimet e marra duke u bazuar në rregulloren për menaxhimin e mbeturinave	Zbatimin e rregullores Menaxhimin e mbeturinave	Rregullorja menaxhimin mbeturinave është zbatuar
		Njoftimi i qytetarëve për mos huthjen e mbeturinave duke shpërndar broshura, njoftime përmes rrjeteve sociale, dhe duke bashkëpunuar me drejtorin e Arsimit	Shpërndarja e fletushkave vetëdijësuese dhe duke aplikuar gjoba për ndotësit	Eshtë realizuar pjesërisht përmes disa fushatave në shkollat dhe aksioneve të pastrimit.
O8	Realizimi i kampanjës për vetëdijësim dhe informim rreth efektive pozitive dhe negative të mbeturinave, rreth pozitës dhe rregullave të grumbullimit dhe hedhjes së mbeturinave.			

1.8. Performance e shërbimit

Efikasiteti i stafit të ofruesit të shërbimeve:

Stafi i angazhuar në ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Shtimes, përbehet nga 40 veta dhe përfshin stafin direkt të angazhuar në operime si dhe stafin indirekt dhe administrativ të cilët i mbështesin ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave. Në kuadër të stafit direkt përfshihen 22 veta, 15 nga të cilët janë punëtorë. Ndërsa në kuadër të stafit indirekt dhe administrativ janë 18 veta.

Nëse analizojmë efikasitetin e stafit të angazhuar në menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Shtimes, efikasiteti për ton mbeturina të grumbullura është 112 ton/kokë stafi, ndërsa për ekonomi familjare është 77.7 Ekonomi Familjare/ kokë stafi për kokë stafi.

Më shumë detaje janë prezantuar në tabelën 16 ku është prezantuar efikasiteti i stafit të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Shtimes.

Tabela 16: Efikasiteti i stafit të shërbimeve të MM	
Kategoria	Numri i stafit
Stafi direct	
Kryepunëtorë	1
Shoferë	6
Punëtorë	15
Total staf direkt:	22
Staf indirekt dhe administrative	
Drejtorët e bordit	1
Menaxhmenti i lartë ¹¹	
Zyrtarë të rangut të mesëm	4
Staf teknik	1
Zyrtarë të rangut fillestar	6
Staf tjetër	6
Total staf indirekt dhe administrative:	18
Total staf të MM	40
Mbeturina të grumbulluara	4.486 ton/vit
Efikasiteti i stafit / ton mbeturina të grumbulluara	112 ton/ staf
EF të shërbyera	3109
Efikasiteti i stafit / EF të shërbyera	10.7/'000 konsumator

¹¹ KE, ZKF, drejtorët e departamenteve, dhe pozita tjera të larta.

Performanca e aseteve të grumbullimit dhe transportit:

Performanca e pajisjeve të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave është e prezantuar në tabelën 17. Duke i referuar të dhënave në tabelë konstatojmë se kamionët e njesis se KRM “Pastertia”, në Shtimes kalojnë në total kilometrashë prej 25360 km/vit ose 317 xhiro dhe grumbullojnë 4486 ton mbeturina. Mjetet transportuese përkatësisht kamionët e ndërmarrjes “Pastrimi” shpenzojnë 10976 litra naftë/vit. Konsumi i naftës për 100 km për njësi transportuese siilet rreth 15 litra.

Tabela 17: Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Kategoria	Performanca
Kamionët/traktoret në operim	3 kamion dhe 3 traktor
Kapaciteti maksimal operues (ton)	NA
Mbeturinat e Grumbulluara (ton/vit)	4486 ton/vit
Xhiro (xhiro/vit)	317
Kilometrazhi (km/vit)	25360 km
Konsumi i naftës (l/vit)	NA
Efikasiteti i Shfrytëzimit %	NA
Efikasiteti i shfrytëzimit të kamionëve	NA
Konsumi i naftës l/100km	15
Konsumi i naftës l/ton	NA

1.9. Performanca financiare e MM

1.9.1. Shpenzimet e shërbimit të MM

Shpenzimet e shërbimit të menaxhimit të mberuinave përfshijnë shpenzimet e pagave, shpenzimet e materialit direkt dhe shpenzimet indirekte dhe administrative (tabela 17). Shpenzimet vjetore të pagave për menaxhimin e mberuinave janë 170.704 euro. Shpenzimet e materialit direkt përfshijnë zërat si nafta, pagesa e deponisë, mirëmbajtja dhe riparimet e kamionëve dhe kontejnerëve, regjistrimi i kamionëve, etj.,N/A. Shpenzimet indirekte dhe administrative përfshijnë zërat si: tatimi mbi fitimin, tatimi mbi pronë, sigurimi, pagesa e licencave, shërbime komunale, kostot e komunikimit, kostot e trajnimit, shpenzimet e përfaqësimit, qeraja, kostot e transportit; të konsumueshme dhe shpenzime të tjera administrative.

Tabela 18. Shpenzimet e shërbimit të MM

Kategoria e kostove dhe shpenzimeve	Kostot (€/vjet)	Pjesëmarrja %
Shpenzimet e pagave	170.704,00 Euro	100
Shpenzimet e materialit direkt ¹²	NA	NA
Shpenzimet indirekte dhe administrative	NA	NA
Amortizimi	NA	NA
Total:	NA	NA

1.9.2. Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM

Të dhënat e prezantuara në tabelën 19 i referohen të hyrave dhe arkëtimit nga shërbimet operative primare dhe sekondare për menaxhimin e mbeturinave. Sikurse është prezantuar edhe në tabelë shuma e faturave të lëshuar në Euro për vitin 2021 ka qenë 261,284.59, ndërsa të hyrat e realizuara ishin 233,185.26.

Tabela 19: Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM (Euro)

	Të hyrat	Arkëtimi
Të hyrat operative		
-Amvisëritë	155,969.21	131,834.97
-Bizneset	26,212.72	22,943.83
-Institucionet	62,617.33	63,957.74
-Nga shërbimet tjera të kontraktuara	16,485.33	14,448.72
Total:	261,284.59	233,185.26

1.9.3. Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit

Kosto operative vjetore për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave është **N/A**. Shkalla e mbulimit nga faturimi është 84.5%, shkalla e mbulimit nga akrëtimi është 89.3% (tabela 20).

Tabela 20: Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit

Kostot e MM	NA
Të hyrat e MM	261,284.59
Arkëtimi	233,185.26
Shkalla e mbulimit nga faturimi %	84.5%
Shkalla e mbulimit nga arkëtimi %	89.3%
Kosto për ton të mbeturinave	

¹² Nafta, pagesa e deponisë, mirëmbajtja dhe riparimet e kamionëve dhe kontejnerëve, regjistrimi i kamionëve, etj.

1.10. Infrastruktura për ndarje, riciklim dhe deponim të mbeturinave

Qendrat e transferit dhe të riciklimit

Komuna e Shtimes nuk ka stacion të transferit në territorin e tij, por ka të drejtë ligjore që ta përdorë stacionin e transferimit të mbeturinave në Ferizaj. Kapaciteti i përgjithshëm i këtij stacioni është 50,000 m³, ose 2,500 ton/muaj. Mbeturinat që dërgohen në stacionin e transferit në Ferizaj nuk riciklohen. Në territorin e komunës së Shtimes nuk ka ndonjë formë tjetër të organizuar të grumbullimit të mbeturinave nga qytetarët apo klientët tanë.

Deponia

Në territorin e komunës së Shtimes nuk ka deponi sanitare të mbeturinave. KRM "Pastertia" ka një bashkëpunim shumë të mirë me Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë - KMDK-në dhe ndërmarrja dërgon mbeturina për deponim në Deponinë Sanitare të Mirashit. Cmimi për një (1) ton mbeturina është 5.31€.

1.11. Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme dhe Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim demolimi- Menaxhimi i mbeturinave të këtyre dy kategorive deri më tash është bërë sipas kërkesës nga klientët (Ekonomitë familjare, bizneset, etj.) Në momentet kur gjeneruesit kanë krijuar këto lloje të mbeturinave kanë kërkuar nga operatori i grumbullimit të mbeturinave dhe më pas operatori ka grumbulluar ato. Këto mbeturina të grumbulluara më pas janë ndarë në fraksione dhe janë përdorur për nevoja të ndryshme (si për shëmbull janë shitur, janë djegur, etj.)

Për menaxhimin e mbeturinave shtazore, medicinal dhe kategorive tjera të mbeturinave nuk ofrohet ndonjë praktikë standarde e menaxhimit të tyre. Kjo për shkak se komuna nuk ka gjenerim të madh të këtyre llojeve të mbeturinave dhe rrjedhimisht nuk ka procedure standarde. Mbeturinat medicinal kryesisht menaxhohen nga ministria, kurse për të tjerat kategori nuk ka gjenerim të madh.

2. Objektivat e MM dhe plani operacional

2.3. Vizioni i MM

Vizioni i komunës së Shtimes për menaxhimin e mbeturinave thotë: ***“Shtimja, një komunë e cila promovon menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave të bazuar në parimet e ekonomisë qarkore me synim mbrojtjen e mjedisit, prezervimin e resurseve natyrore dhe zhvillimit ekonomik lokal”!***

Komuna e Shtimes synon që të ofrojë shërbime të menaxhimit të mbeturinave gjithë qytetarëve të saj. Krahas këtij veprimi komuna synon që të ngrisë kualitetin e shërbimeve duke bashkëpunuar me qytetarët e saj dhe akterët tjerë relevant.

Duke promovuar konceptin 3R dmth zvogëlim, ripërdorim, dhe riciklim komuna synon që gradualisht të fillojë të ndajë mbeturinat (nga ekonomi familjare, tek shkollat dhe institucionet, dhe biznese), të edukojë qytetarët rreth përfitimeve për ndarje të mbeturinave dhe të krijojë infrastrukturë për zhvillim ekonomik lokal, pra të krijojë mundësi qytetarëve që të krijojnë biznese financiarisht të qëndrueshme në sektor. Përfundimisht, komuna synon që të krijojë një mjedis më të pastër për qytetarët e saj, gjë që do të ndikonte në ngritjen e mirëqenies për qytetarë.

2.4. Objektivat dhe caqet e MM

Formati i standardizuar i PKMM përmban pesë objektiva të paraqitur në tabelën e mëposhtme :

Tabela 21: Lista e propozuar e objektivave të planit	
Numri objektivit	Emërtimi
Objektivi 1	Parandalimi dhe minimizimi i gjenerimit të mbeturinave
Objektivi 2	Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave
Objektivi 3	Ofrimi i shërbimeve cilësore, efektive dhe efikase të shërbimeve
Objektivi 4	Eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave
Objektivi 5	Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave

2.4.1. Objektivi 1: Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave

Komuna e Shtimes, është e përkushtuar që të bëjë hapa të vendosur në parandalimin respektivisht reduktimin e gjenerimit të mbeturinave. Parandalimi dhe reduktimi i gjenerimit të mbeturinave shkon në linjë me hierarkinë e prioriteteve të menaxhimit të mbeturinave të sanksionuar me ligj dhe strategji.

Tabela 22: Korniza strategjike e Objektivit 1

Aktiviteti / masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
		2022	2023	2024	2025	2026	2027
Mbeturina të grumbulluara për kokë banori (kg /pcp /ditë)	Sasia e mbeturinave (kg /pkb/ditë)	0.62	0.62	0.61	0.61	0.60	0.60
Riorganizimi i shërbimit për të mundësuar matjen e mbeturinave të grumbulluara	Sherbimi është riorganizuar që të mundësojë matjen	-	-	1	-	-	-
Zbatimi i tarifave volumetrike	Tarifat janë miratuar dhe po aplikohen	-	-	-	1	-	-
Futja e pakos stimuluese	Pakoja stimuluese është hartuar dhe miratuar	-	-	-	1	-	-
Shpërndarja e komposterëve individual	Numri i kompostereve të shpërndare	-	-	20	20	20	20
Zbatimi i fushatës informative	Fushata informative zbatohet	-	1	1	1	1	1

2.4.2. Masat dhe aktivitetet për parandalimin dhe reduktimin e mbeturinave

Në vijim jepen disa nga masave / aktivitetet të rekomanduar për arritjen e kësaj objektive:

- Zbatimi i tarifave vëllimore PAYT ku konsumatori faturohet në bazë të mbeturinave të hudhura (ngashëm me shërbimin e rrymës dhe ujit)
- Facilitimi i hapjes së dyqaneve pa paketim dhe rimbushëse
- Facilitimi i hapjes së restauranteve dhe hoteleve “zero waste”
- Futja e stimuljeve të përshtatshme fiskale, tarifave preferenciale, kontraktimi dhe prokurimi publik preferencial nga këto subjekte
- Në koordinim me nivelin qendror të bëhet ndalimi i qeseve plastike dhe paketimit njëpërdorimësh
- Kompostimi individual
- Fushatat vetëdijësuese për parandalim dhe reduktim të mbeturinave.

Megjithatë komuna duhet në bazë të specifikave të veta t’i përshtas masat të cilat do të ndërmarr për realizimin e kësaj objektive.

Disa masa varen nga niveli qendror si ndalimi i qeseve plastike dhe ambalazhit. Në këto raste GP duhet të përcjelli zhvillimet nga niveli qendror dhe ti zbatojë përbrenda territorit të komunës.

Sa i përket treguesit ai duhet të caktohet nga analiza e gjenerimit dhe kompozicionit të mbeturinave. Nëse komuna nuk ka bërë analiza të këtij treguesi atëherë duhet ta lejë të zbrazët vlerën bazë.

Për më shumë le të referohet doracakut për seksionin e parandalimit dhe reduktimin e mbeturinave!

2.4.3. Objektivi 2: Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave

Fokusi primar i këtij objektivi ka të bëjë me ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale si dhe kategorive tjera të mbeturinave nën kompetencë komunale me theks të veçantë në MND, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat komerciale.

Edhe pse gomat, produktet elektrike dhe elektronike, bateritë etj., nuk janë kompetencë komunale, megjithatë duke iu referuar kuadrit ligjorë dhe praktikave të jashtme, komuna do të organizoj skemën e grumbullimit të organizuar të këtyre mbeturinave në kuadër të skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

Tabela në vijim jep kornizën strategjike për objektivin 3 së bashku me disa masa aktivitete të propozuara:

Tabela 23: Korniza strategjike e Objektivit 2

Masat / aktivitet / treguesi i performancës	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
		2022	2023	2024	2025	2026	2027
Studimi i fizibilitetit për modelin e operimit të qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit	Studimi i fizibilitetit është zbatuar			1			
Zgjerimi i infrastrukturës ndarëse të mbeturinave në burim	% EF me ndarje në burim	0	5	10	20	30	40
Riciklimi i letrës	% e riciklimit të letrës dhe kartonit	0%	5%	10%	20%	30%	40%
Riciklimi i plastikës	% e riciklimit të plastikës	0%	5%	10%	20%	30%	40%
Riciklimi i metalit	% e riciklimit të metalit	0%	5%	10%	20%	30%	40%
Riciklimi i qelqit	% e riciklimit të qelqit	0%	5%	10%	20%	30%	40%
Studim i fizibilitetit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale të riciklueshme dhe biodegraduese	Studimi i fizibilitetit është zbatuar		1				
Funksionalizimi i qendrës së grumbullimit dhe riciklimit	Qendra e grumbullimit është funksionalizuar dhe futur në operim			1			
Caktimi i lokacionit të deponisë së MND	Lokacioni i deponisë të MND është përcaktuar		1				
Studimi i fizibilitetit për modelin e operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të MND në komune.	Studimi i fizibilitetit është zbatuar			1			
Kontraktimi i operatorit privat për MND	Operatori është kontraktuar			1			

Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave 2022-2026

Kontraktimi i operatorit privat për grumbullimin dhe transportin dhe riciklimin e mbeturinave të riciklueshme jo degraduese	Operatori kontraktuar	është	1
Kontraktimi i operatorit privat për grumbullimin dhe transportin dhe riciklimin e mbeturinave bio degraduese	Operatori kontraktuar	është	1

Analiza e potencialit të gjenerimit, kompozicionit dhe riciklimit të mbeturinave

Analiza në fjalë nisët nga parashikimet demografike të popullatës.

Tabela 24: Parashikimet demografike të popullatës

Vendbanimi	Numri i popullatës					
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Qyteti (rritje / zbritje)	Rritje	Rritje	Rritje	Rritje	Rritje	Rritje
Qyteti (banorë)						
Zona ruarle (rritje / zbritje)	Rritje	Rritje	Rritje	Rritje	Rritje	Rritje
Zona ruarle (banorë)						
Total banorë						

Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave është dhënë në tabelat në vijim i bazuar në studimin e kompozicionit të mbeturinave që është marrë nga studimi për komunën fqinje të Ferizajt, në mungesë të një hulumtimi për komunën e Shtimes.

Tabela 25: Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave

	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Popullata në zonën urbane						
Gjenerimi për kokë banori ZU kg/vit	224	224	224	224	224	224
Gjenerimi i mbeturinave ZU ton/vit						
Popullata në zonën rurale						
Gjenerimi për kokë banori ZR kg/vit	224	224	224	224	224	224
Gjenerimi i mbeturinave ZR ton/vit	4,159.2	4,541.8	4,625.3	4,648.2	4,671.3	4,694.6
Popullata në komune (total)						
Gjenerimi vjetor i mbeturinave ton/vit	5,788.5	6,179.2	6,270.8	6,403.9	6,293.4	6,364.9

Parashikimi i kompozicionit të mbeturinave të gjeneruara është dhënë në tabelat në vijim i bazuar në studimin e kompozicionit nga Komuna e Ferizajt, meqenëse në komunën e Shtimes nuk ka pasur ndonjë hulumtim për kompozicionin e mbeturinave.

Tabela 26: Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave sipas kompozicionit

Fraksioni	2023	2024	2025	2026	2027
Letër dhe karton	21.5	21.5	21.5	22	22
Qelq	3.5	3.5	3.5	3.5	3.5
Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat	34.1	34.1	34.1	34	34
Tekstil dhe veshjet	7.4	7.4	7.4	7.5	7.5
Pllastika	20.9	20.9	20.9	21	21
Metal	1.8	1.8	1.8	2	2
Të tjera	10.8	10.8	10.8	10	10
Letër dhe karton	1,328.5	1,348.2	1,376.8	1,384.5	1,400.3
Qelq	216.3	219.5	224.1	220.3	222.8
Mbeturina bio-degraduese ¹³	2,107.1	2,138.3	2,183.7	2,139.8	2,164.1
Tekstil dhe veshjet	457.3	464.03	473.9	472.01	477.4
Pllastika	1,291.5	1,310.6	1,338.4	1,321.6	1,336.6
Metal	111.2	112.9	115.3	125.9	127.3
Të tjera	667.4	677.2	691.6	629.3	636.5

Në tabelën në vijim janë dhënë caqet preliminare të komunës karshi ripërdorimit / riciklimit të fraksioneve të caktuara të mbeturinave komunale si letra, plastika, qelqi dhe metali.

Megjithatë për caqe më të sakta të ripërdorimit dhe riciklimit komunat duhet që të zbatojnë një studim të fizibilitetit të riciklimit të mbeturinave në komunë. Në tabelën në vijim janë vendosur caqet preliminare të riciklimit në %.

Tabela 27: Analiza e potencialit të mbeturinave që mund të riciklohen

Fraksioni	2023	2024	2025	2026	2027
Letër dhe karton	5%	10%	20%	30%	40%
Qelq	5%	10%	20%	30%	40%
Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat	5%	10%	20%	30%	40%
Tekstil dhe veshjet	5%	10%	20%	30%	40%
Pllastika	5%	10%	20%	30%	40%
Metal	5%	10%	20%	30%	40%
Të tjera	5%	10%	20%	30%	40%
Letër dhe karton	66.4	134.8	275.4	415.4	560.1
Qelq	10.8	22	44.8	66.1	89.1
Mbeturina bio-degraduese ¹⁴	105.4	213.8	436.7	641.9	865.6
Tekstil dhe veshjet	22.9	46.4	94.8	141.6	191
Pllastika	64.3	131.1	267.7	396.9	534.6
Metal	5.6	11.3	23.1	37.8	50.9
Të tjera	33.4	67.7	138.3	188.8	254.6

¹³ Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat

¹⁴ Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat

Avancimi i sistemit të ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave komunale:

- Zgjerimi i infrastrukturës për ndarje në burim të mbeturinave komunale:

Komuna e Shtimes është e përkushtuar që të bëjë ndarjen në burim të mbeturinave komunale. Format e ndarjes varen nga faktorë të ndryshëm dhe mundë të marrin forma sa vijon:

- Ndarja në dy fraksione „thatë dhe të lagësht“ me grumbullim derë më derë;
- Ndarja në tre fraksione „recikluese jo-biodegraduese, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim derë më derë;
- Ndarja në dy fraksione „thatë dhe të lagësht“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët;
- Ndarja në tre fraksione „recikluese jo-biodegraduese, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët;
- Ndarja në mbi tre fraksione „letër – qelq – plastikë - metal, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët.

Forma e ndarjes kushtëzohet nga tipi i vendëbanimit (rezidencial dhe banim kolektiv), kapaciteti buxhetorë, infrastruktura ricikluese e të ngjashme.

Megjithatë tipi i ndarjes së mbeturinave do të përcaktohet nga **plani i riorganizimit të shërbimit** që do ta zhvilloj komuna (tek objektiva 3).

Në tabelën në vijim do të jepet orari i shtrirjes së ndarjes së mbeturinave në burim për komunën e Shtimes:

Tabela 28: Orari i ndarjes së mbeturinave në burim

	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Mbulimi total me shërbim	74%	78%	80%	85%	90%	100%
Mbulimi me ndarje në burim	5%	10%	15%	25%	35%	45%

- Zbatimi i skemës së grumbullimit të ndarë, transportit dhe riciklimit të mbeturinave të riciklueshme jo të degradueshme:

Komuna e Shtimes do të zbatoj një **studim të fizibilitetit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale i cili përfshin si fraksion të ndarë mbeturinat e riciklueshme jo-biodegraduese¹⁵**. Studimi do të bazohet në analizën e kompozicionit, tregun e të riciklueshmeve dhe sektorin e ricikluesve privat dhe poashtu do të marr parasysh kërkesat ligjore dhe politikat kombëtare të menaxhimit të mbeturinave si dhe praktikatat më të mira.

Sipas strategjisë së mbeturinave 2021 – 2030 parashihet të zbatohet skema e sistemit të kthimit të depozitës për ambalazhet e pijeve tek prodhuesit dhe tregëtarët e pijeve që

¹⁵ Letra, plastika, metali, tekstili ,etj.

paraqet një përqindje të konsiderueshme të këtyre mbeturinave. Poashtu strategjia e mbeturinave parasheh operimin e qendrave të riciklimit ku do të dërgohen këto mbeturina.

Megjithatë deri sa të zbatohet skema e kthimit të depozitës dhe funksionalizohet qendra e riciklimit komuna do të synoj të bëjë partneritet me ricikluesit privat për të bërë grumbullimin dhe transportin e të riciklueshmeve jo-biodegraduese.

Pra komuna sa i përket mbeturinave të riciklueshme jobiodegradues do të zbatoj:

- studimin e fizibilitetit të zbatimit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave të riciklueshme të padegradueshme
- zhvillimin e partneritet me ricikluesit privat për grumbullimin dhe transportin e këtyre mbeturinave
- Zbatimi i skemës së grumbullimit të ndarë, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale biodegraduese:

Ngjashëm si me mbeturinat e riciklueshme jo të degradueshme, komuna do të zbatoj një **studim të fizibilitetit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale i cili përfshion si fraksion të ndarë mbeturinat biodegraduese**. Mbeturinat që do të përfshihen në këtë fraksion do të jenë mbeturinat nga ushqimet, vajrat e përdorura ushqimore, dhe mbeturinat nga parqet, tregjet e gjelbërta dhe hapësirat publike.

Sipas strategjisë secili rajon do të ketë një qendër të kompostimit të centralizuar ku do të dërgohen **mbeturinat biodegraduese ushqimore**. Por deri sa të ndërtohet dhe funksionalizohet kjo qendër komuna do të konsideroj zhvillimin e skemës lokale të kompostimit përmes angazhimit të operatorëve privat të interesuar që të grumbullojnë dhe transportojnë këto mbeturina.

Komuna do të ndërtoj skemën lokale të kompostimit për **mbeturinat biodegraduese nga parqet, tregjet e gjelbërta dhe hapësirat publike** të cilat për shkak të specifikave të tyre duhet të kompostohen lokalisht meqë transportimi i tyre është i kushtueshëm dhe joefikas.

Sa i përket **vajrave të përdorura ushqimore** komuna do të u kërkoj objekteve gastronomike që i prodhojnë këto vajëra me shumicë të lidhin kontrata valide me operatorët të licencuar të vajërave ushqimore nga MMPHI të cilët do të bëjnë grumbullimin e organizuar të këtyre vajrave. Komuna do të organizoj mbikëqyrjen dhe inspektimin e mbarëvajtjes së kësaj skeme të organizimit dhe do të shqiptoj dënime në rast të shkeljeve.

Pra komuna sa i përket mbeturinave biodegraduese do të zbatoj:

- studimin e zbatimit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave komunale biodegraduese;
- zhvillimin e skemës lokale të kompostimit në partneritet me ricikluesit privat
- inspektimin e lokaleve gastronomike sa i përket zbatimit të kontratës për vajra mbeturinë.

Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale:

- Hapja e qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit:

Komuna e Shtimes planifikon të hap **1 qender për grumbullimin dhe ripërdorimin e mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale**. Për hapjen e këtyre qendrave komuna do ta caktoj lokacionin.

Në këtë objekt qytetarët do të dërgojnë artikujt e padëshiruar të tyre sa vijon:

- Mobilje dhe orendi
- Tekstil dhe veshëmbathje
- Pajisje shtëpiake dhe mbeturina tjera të vëllimshme

Përpos këtyre artikujve të padëshiruar qytetarët do të dorëzojnë edhe gomat, bateritë, vajrat mbeturinë dhe mbeturina tjera.

Komuna do të zbatoj një **studim të fizibilitetit të modelit të operimit** të qendrës (qendrave) përmes së cilit do të analizohet dhe do të vendoset se a do ta menaxhoj vetë këtë qendër komuna apo ta angazhoj një operator privat.

Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi:

Sa i përket MND ligji parasheh caktimin e lokacionit të deponisë që është një zgjidhje e përkohshme dhe ndërtimin dhe funksionalizimin e qendrës së grumbullimit dhe riciklimit të këtyre mbeturinave e cila sipas strategjisë së mbeturinave do të organizohet në formë rajonale.

Komuna sipas ligjit e kontraktos shërbimin me operator të licencuar, cakton tarifat e shërbimit dhe se ndërtuesit kanë të drejtë që ti ndajnë dhe riciklojnë mbeturinat e tyre në kantierin e punimit si dhe ti transportojnë mbeturinat deri te destinacioni i autorizuar.

Komuna e Shtimes nuk e ka të caktuar lokacionin e deponisë për mbeturinat e ndërtimit dhe demolimit. Komuna është në proces të gjetjes së këtij lokacioni i cili do të pajiset me dokumentacion kompetent bazuar në legjislacionin mjedisor në fuqi.

Komuna do të instaloj një sistem i cili në kuadër të lejes ndërtimore do të kërkoj që ndërtuesi të ketë edhe një plan të menaxhimit të mbeturinave ku parashihet sasia e mbeturinave që do të deponohen dhe lokacioni ku do të dërgohen ato. Poashtu inspeksioni do të mbikëqyrë zbatimin e këtij plani dhe të parandaloj hudhje e këtyre mbeturinave në vendë të papërshtatshme.

Në momentin e funksionalizimit të qendres rajonale komuna do të dërgoj mbeturinat tek kjo qendër. Poashtu tarifat do të caktohen në nivel të komunave të cilat do të shërbejnë nga kjo qendër e grumbullimit dhe riciklimit të MND.

Megjithatë komuna për territorin e saj do të zbatoj një **studim fizibiliteti të modelit të operimit të grumbullimit dhe transportit të MND si dhe të riciklimit të tyre nga ndërtuesit**.

Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave nga kujdesi shëndetësor:

Komuna, respektivisht Drejtorati për Shëndetësi, por edhe Drejtorati i Inspeksionit, do të monitoroj menaxhimin e mbeturinave spitalore sipas legjislacionit në fuqi.

Inpektori komunal i mjedisit do të bëjë mbikqyrje inspektive mbi menaxhimin e mbeturinave edhe atyre medicinale në këtë rast, bazuar në Nenin 62, 63, 65, dhe 66 të Ligjit për Mbeturina.

Komuna - Drejtoria përgjegjëse për shëndetësi do të siguroj dhe vendos kontejnerë për hedhjen e barnave të papërdorura dhe me afat të skaduar direkt nga qytetarët.

Prodhuesit e mbeturinave medicinale publik dhe privat gjatë aktivitetit të tyre të kujdesit shëndetësorë, do të hudhin mbeturinat e tyre në mënyrë të klasifikuar mbeturinat sipas llojeve në kontejnerë, enë apo thasë përkatës të siguruar nga vetë ata, deri sa të grumbullohen nga operatori i licencuar që i përpunon dhe i menaxhon ato. Inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë do të siguroj zbatimin e këtij obligimi ligjor.

Operatorët publik dhe privat si prodhues të mëdhenj të mbeturinave medicinale të rrezikshme do të hartojnë planin për menaxhimin e mbeturinave medicinale dhe ekzistenca e këtij plani dhe zbatimi i tij do të kontrollohen nga inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë.

Nëse institucionet shëndetësore nuk i trajtojnë vet mbeturinat spitalore që i krijojnë, atëherë duhet të kenë kontratë me operatorët e licencuar për trajtimin e këtyre mbeturinave. Inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë do të kontrollojë nëse këto kontrata janë të lidhura dhe po zbatohen.

Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave shtazore nga thertoret:

Sipas strategjisë së mbeturinave, mbeturinat shtazore nga therrtoret do të dërgohen tek qendra e grumbullimit dhe riciklimit në zonën industriale në Drenas të ndërtuar nga BE. Megjithatë kjo qendër ende nuk po funksionalizohet që po na e pamundëson organizimin e kësaj skeme.

Komuna do të organizoj këtë shërbim për fazën tranzitore deri në funksionalizim të qendrës duke i dërguar këto mbeturina nga operatori i grumbullimit të mbeturinave për të bërë varrimin e tyre të gëlqelosur dhe njëkohësisht do të shikoj mundësin e angazhimit të operatorëve privat të licencuar nga AVUK që të bëjnë grumbullimin e organizuar të këtyre mbeturinave tek impjantet e tyre.

Mishtoret, therrtoret dhe industritë përpunuese të mishit duhet të sigurojnë kontejnerë hermetik të ndarë ku do të hudhin mbeturinat shtazore deri në momentin e grumbullimit dhe të kenë kontrata valide me operatorin të cilat do të inspektohen nga komuna në mënyrë periodike.

Aktivitet vetëdijësues për ripërdorim dhe riciklim të mbeturinave:

Komuna do të organizoj fushata informative të komunikimit me publikun sa i përket ndarjes, ripërdorimit dhe riciklmit të mbeturinave komunale, dhe kategorive tjera.

Informimi do të sqaroj se si duhet të hudhen mbeturinat në kontejnerë / shporta të ndara, për dërgimin e mbeturinave në qendrën e grumbullimit dhe ripërdorimit, dhe të ngashme. Fushata do të organizohet që të targetoj institucionet shkollore për të ngritur nivelin e edukimit mjedisorë.

2.4.4. Objektivi nr. 3: Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme të MM

Objektivi 3 ka të bëjë me komponentën e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale dhe kategorive tjera të mbeturinave nën kompetencë komunale. Ky objektivi synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve me theks të aspekteve të qëndrueshmërisë financiare dhe të kostos.

Tabela 29: Korniza strategjike e objektivit 3							
Aktiviteti / masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
		2022	2023	2024	2025	2026	2027
Mbulimi me shërbim të grumbullimit dhe transportit	% e popullatës së shërbyer	74%	78%	80%	85%	90%	100%
Plani i ri operativ do të hartohet (revidohet)	Plani operativ është hartuar (reviduar)	-	1	-	-	-	-
Marrja përsipër e faturimit dhe arkëtimit nga komuna	Komuna ka marrë përsipër faturimin dhe arkëtimin	-	-	1	-	-	-
Zgjidhja e statusit të rasteve sociale	Pagesa e faturave për rastet sociale është zgjidhur	-	-	1	-	-	-

Në vijim jepen masat dhe aktivitetet kyçe të objektivës 3:

Zgjerimi i mbulimit me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Tabelat në vijim jep orarin e zgjerimit të shërbimit. Komuna është e përkushtuar që të zgjeroj ofrimin e shërbimit në tërë territorin e saj. Strategjia e zgjerimit është që fillimisht të ofrohet shërbim i plotë në zonën urbane si dhe mbulimi me shërbim edhe për zonën rurale.

Tabela 30: Strategjia e zgjerimit me shërbim

	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Mbulimi me shërbim	74%	78%	80%	85%	90%	100%

Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale:

Komuna do të komisionoj **planin e ri operativ** i cili do të bëjë planin e riorganizimit të shërbimit i cili do të rezultoj përmirësimin e cilësisë së shërbimit përmes:

- Optimizimit të pikave të grumbullimit dhe frekuencës së ofrimit të shërbimit:
- Sigurimin e infrastrukturës adekuate për grumbullim dhe transport të mbeturinave komunale

Komuna do të **digjitalizoj sistemin e grumbullimit të mbeturinave** i cili do të përmirësoj cilësinë dhe efikasitetin e shërbimit. Ky sistem do të ofroj informacionet për lëvizjet e kamionëve, informatat mbi lokacionin e kontejnerëve, nivelin e mbushjes dhe informatave tjera relevante si dhe i njëjti do të integrohet me databazën e kujdesit të konsumatorëve.

Komuna do të ndërmerr **kampanjë informative** për ti informuar qytetarët për mënyrën e re të grumbullimit të mbeturinave përfshi mënyrën e hudhjes së mbeturinave, frekuencën e shërbimit e të ngjashme.

Përmirësimi i efikasitetit operativ dhe të koston

Komuna ka përcaktuar si objektiv përmirësimin e efikasitetit operativ dhe të koston në funksion të përmirësimit të qendrueshmëris financiare. Shtyllat kryesore të këtij plani janë optimizimi i efikasitetit të stafit dhe harxhimit të naftës.

Përmirësimi i efikasitetit të stafit

Komuna do të zbatoj aktivitetet sa vijon për ta përmirësuar efikasitetin e stafit të ofruesve publik të shërbimeve:

- Kontrollin (ngrirjen) e regrutimit të stafit të ri administrativ dhe trajnimit të stafit ekzistues
- Zgjerimin e zonës së shërbimeve
- Diversifikimin dhe zgjerimin e shërbimeve
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së efikasitetit të stafit

Zyrtarët e MM dhe personat tjerë të përfshirë në planifikim, monitorim dhe mbikëqyrje të menaxhimit të mbeturinave duhet të mbajnë një kontroll strikt të numrit të stafit sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 31: Efikasiteti i stafit

	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Stafi direkt	19	-	-	-	-	-
Stafi indirekt dhe administrativ	17	-	-	-	-	-
Amvisëritë (EF) e shërbyera	3041	-	-	-	-	-
Efikasiteti i stafit për 1000 konsumatorë të shërbyer	10.7	-	-	-	-	-

Përmirësimi i efikasitetit kostos së grumbullimit dhe të harxhimit të naftës

Harxhimi i naftës është njëri ndër zërat më të lartë të kostove rrjedhëse të operatorëve të shërbimit rreth 15% të kostove rrjedhëse në nivel të sektorit dhe kjo i atribuohet në masë të konsiderueshme joefikasitetit operativ por edhe keqmenaxhimit.

Masat / aktivitetet e propozuara përfshijnë:

- **Hartimi i planit të ri operativ** (riorganizmin e zonës dhe optimizimin e marshutave dhe frekuencës së grumbullimit)
- Zëvendësimi i kamionëve të vjetër me kamionë të rinjë apo funksional (second-hand)
- Ndërtimin e transfer stacionit për të shkurtuar distancën
- Përforsimin e kontrollit të brendshëm
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së harxhimit të naftës
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së kostos njësi të grumbullimit dhe transportit

Përmirësim i performancës financiare të ofrimit të shërbimit

Komuna ka përcaktuar si objektiv përmirësimin e qëndrueshmëris financiare të ofrimit të shërbimeve. Masat kryesore të përmirësimit të qëndrueshmëris financiare janë:

- Kalimi i tarifave për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave mbi principet e mbulimit të kostos
- Marrja përsipër e faturimit dhe arkëtimit nga komuna
- Zgjidhja e pagesës së faturave për rastet sociale

2.1.1. Objektiv nr. 4: Trajtimi dhe deponimi i sigurt i mbeturinave si mjeti i fundit

Objektivi 4 ka të bëjë me komponentën e deponimit të sigurt të mbeturinave, dhe synimi kryesor i këtij objektivi është eliminimi i deponive ilegale dhe parandalimi i krijimit të deponive të reja ilegale. Përmes këtij objektivi komuna do të fokusohet në rehabilitimin e deponive për të arritur standardet mjedisore.

Tabela 32: Korniza strategjike e objektivit 4

Aktiviteti / masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
		2022	2023	2024	2025	2026	2027
Rehabilitimi i deponisë ilegale të mbeturinave	Numri i deponive ilegale	23	20	15	10	5	0

2.1.2. Objektivi 5: Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave

Tabela 33: Korniza strategjike e objektivit 5

Aktiviteti / Masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
		2022	2023	2024	2025	2026	2027
Revidimi i RrK të MM	RrK e MM është reviduar	-	-	1	-	-	-
Emërimi i zyrtarit / Formimi i njësitit	Zyrtari i MM është emëruar/Spektori është formuar	1	-	-	-	-	-
Kalimi i procesit tarifarë	Tarifat e reja janë kalkuluar dhe miratuar	-	-	1	-	-	-
Kontraktimi i operatorit për grumbullim dhe transport	Operatori i licencuar është kontraktuar	-	-	1	-	-	-
Kontraktimi i operatorit për MND	Operatori i licencuar është kontraktuar	-	-	1	-	-	-

Emërimi i zyrtarëve komunal apo themelimi i njësitit për MM

Komuna e ka zbatuar këtë obligim në vitin 2020 me emërimin e zyrtarit komunal të MM.

Emërimi i inspektorit mjedisorë

Komuna e ka zbatuar këtë obligim në vitin 2020 me emërimin e inspektorit mjedisorë të MM.

Kalimi i procesit tarifarë

Komuna e ka kaluar procesin tarifarë në vitin 2019 dhe planifikon që ti nënshtrohet të njëjtit gjatë vitit 2023 për të reflektuar ndryshimin e kostove dhe parametrave tjerë relevant.

Zbatimi i programit të trajnimit dhe mbështetjes së proceseve për komunën dhe operatorët

Ky program do të dizajnohet që të i ngris kapacitetet në zbatimin e proceseve si revidimi dhe zbatimi i PKMM, amendimi i RrK të MM, kalimin e procesit tariforë, draftimin dhe monitorimin e kontratave të shërbimit dhe partneriteti publiko privat, zbatimin e skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe skemës së kthimit të depozitës, ekonominë qarkore, riciklimin e mbeturinave e të ngjashme.

3. Plani i MM në kushte emergjente

Komunat duhet të bëjnë planifikimin e MM në kushte emergjente sipas kërkesave të Ligjit nr. 04/l-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, planit kombëtar të reagimit emergjent të Agjencisë për menaxhimin emergjent dhe ndonjë dokumenti tjetër relevant.

Fatkeqësitë sipas ligjit konsiderohen ngjarjet të shkaktuara nga forcat madhore të natyrës apo forcat tjera te pakontrolluara, të cilat rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve dhe pronave. Në fatkeqësi përfshihen: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, zjarret, shpërthim i sëmundjeve infektive aksidentet që përfshijnë trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, zjarret, aksidentet ekologjike dhe industriale, lufta dhe gjendja emergjente, etj.

Ngjarja e fundit që ka kualifikuar për emergjencë apo fatkeqësi ka qenë pandemia Covid 19 dhe e cila na ka ofruar disa përvoja të dobishme.

Komuna do ta amendoj planin komunal të reagimit emergjent duke shtuar kaptinën për menaxhimin e shërbimit të mbeturinave në kushte emergjente!

4. Plani financiar, i veprimit dhe i monitorimit

Tabelat në vijim paraqesin në mënyrë tabelare planin financiar, te veprimit dhe monitorimit sipas objektivave përkatëse. Tabelat prezantojnë objektivat dhe aktivitetet e planit, përgjegjësit për zbatimin e këtyre aktiviteteve, afatet kohore të implementimit, buxhetin e planifikuar, treguesit, vlerën bazë, caqet dhe realizimin. Këto tabela të vlerësimit dhe monitorimit do të shëbejnë edhe me rastin e revidimit të planit të ri, për të analizuar nivelin e zbatimit të planit paraprak sipas objektivave të parcaktuara.

Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave 2022-2026

Tabela 34: Plani financiar, veprimet dhe monitorimi - Objektivi 1 „Parandalimi dhe reduktimi“

Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjëse	Afati i implementimit dhe buxheti	2023	2024	2025	2026	2027	Burimi financimit
Riorganizimi i shërbimit								
o Plani i riorganizimit të shërbimit	DSHP				30,000 €			30,000 €
o Sigurimi i infrastrukturës matëse	DSHP				5,000 €			5,000 €
Zbatimi i tarifave voluntetrike					25,000 €			25,000 €
o Kalimi i tarifave PAYS (procesi)	DSHP			5,000 €				5,000 €
o Azhurnimi i taksës për faturimet	DSHP			1,500 €				1,500 €
o Zbatimi i taksës për PAYS	KRM			3,500 €	x			3,500 €
Nxjerrja e pakos stimuluese për bizneset					1,500 €			1,500 €
o Studimi i mënyrës së futjes së stimujve fiskal	DF				1,500 €			1,500 €
o Pakoja e lehtësimeve fiskale	DF				x			
Shpërndarja e kompozicionit të ndarjes për EF dhe restorante				1,200 €	1,200 €	1,200 €	1,200 €	50% komuna; 50% donacion
Rritja e ndërgjegjësisë për çështjet e minimizimit			300 €	300 €	300 €	300 €	300 €	Komuna
o Fushata e veprimtarisë	DSHP		300 €	300 €	300 €	300 €	300 €	Komuna
Total objektiva 1 - Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave			300 €	6,500 €	33,000 €	1,500 €	1,500 €	42,800 €

Tabela 35: Plani financiar, veprimet dhe monitorimi - Objektivi 2 „Ripërdorimi dhe riciklimi“

Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjëse	Afati i implementimit dhe buxheti	2023	2024	2025	2026	2027	Burimi financimit
Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit të mbeturinave								
Ndarja dhe riciklimi i mbeturinave komunale			5,000 €	5,000 €	48,500 €	5,000 €	5,000 €	2,500 €
o Studimi i fizibilitetit të ndarjes dhe operimit	DSHP				5,000 €			5,000 €
o Zgjerimi i ndarjes së mbeturinave në burim	DSHP		5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	25,000 €
o Kontraktimi i operatorit të riciklueshmeve	DSHP				5,000 €			5,000 €
o Zhvillimi i skemës lokale të kompostimit	DSHP				35,000 €			35,000 €

Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinëve 2022-2026

Menaxhimi i lokaliteteve gastronomike për vajër	Inspektimi i lokaliteteve gastronomike për vajër	DSHP	X	X	X	X			
	Bashkimi i këmbës ndërkomunal të kompostimit	DSHP							
	Menaxhimi i mbeturive të vëlleshme dhe komerciale		5,000 €	25,000 €					30,000 €
	Studimi i fizibilitetit	DSHP	5,000 €						5,000 €
Menaxhimi i lokaliteteve të grumbullimit/ripërdorimit ¹⁶	Ndërtimi i qendrave të grumbullimit/ripërdorimit ¹⁶	DSHP		25,000 €					25,000 €
	Funksionalizimi i qendrave	DSHP							
	Menaxhimi i mbeturive nga ndërtimet demoli								
	Caktimi i lokacionit	DSHP	X		5,500 €	75,000 €			80,500 €
Menaxhimi i lokaliteteve nga ndërtimet demoli	Kontraktimi me operatorin	DSHP		3,500 €					3,500 €
	Caktimi i tarifave	DSHP		2,000 €					2,000 €
	Rehabilitimi	DSHP				75,000 €			75,000 €
	Bashkimi i këmbës ndërkomunale të menaxhimit	DSHP						X	
Menaxhimi i mbeturive shtazore	Lehtësimi i kontraktimit të operatorit privat	DSHP	X	X					
	Inspektimi i kontraktimit	DSHP	X	X	X	X	X	X	
	Menaxhimi i mbeturive medicinale								
	Inspektimi i kontraktimit	Inspektorati	X	X	X	X	X	X	
Fushatat e vetëdijësimit	Fushatat e vetëdijësimit		1,500 €	1,500 €	1,500 €	1,500 €	1,500 €	1,500 €	7,500 €
	Total objektiva 2 – Këmbës ndërkomunale dhe ripërdorim		11,500 €	34,000 €	125,000 €	6,500 €	6,500 €	6,500 €	185,000 €

Tabela 36: Plani financiar, veprimet dhe monitorimi - Objekti 3 „Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme“

Masat dhe aktivitetet	Njësitë përgjegjëse	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi financim
		2023	2024	2025	2026	2027		
Përmirësimi i cilësive shërbimit		5,000 €	5,100 €	115,100 €	5,100 €	3,300 €	133,600 €	Komuna
○ Perditesimi i anit operativ	DSHP	5,000 €					5,000 €	

¹⁶ Për komuri e Shtimes parashihet ndërtimi i një pike grumbulluese dhe një qendre të ripërdorimit. Buxheti përfshin infrastrukturën përçelëse të qendrës si rrethoja, kanirat, ba. i , enti, kontejnerët, etj.

¹⁷ Fizibiliteti, i cila makineria dhe pajisjet e nevojshme për menaxhimin e qendrës

Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave 2022-2026

o	Digjitalizimi i stemit të grumbullimit				30,000 €			30,000 €		30% Komuna; 70% Donatori;
o	Furnizimi me porta 120 l			1,800 €	1,800 €		1,800 €	5,400 €		30% Komuna; 70% Donatori;
o	Furnizimi me porta 240 l									30% Komuna; 70% Donatori;
o	Furnizimi me kontejnerë 1.1 m3			3,300 €	3,300 €		3,300 €	13,200 €		30% Komuna; 70% Donatori;
o	Furnizimi me kamionë dhe traktor				80,000 €			80,000 €		Komuna; Donatori;
o	Projekti kapi 1									Komuna
o	Projekti kapi 1									Donatori
o	Projekti kapi 1									KRM
Përmirësimi i performancës operative dhe financiare										
o	Marrja për shërbime faturimit nga komuna			10,000 €				10,000 €		Komuna
o	Zhvillimi i shërbimeve të faturimit			10,000 €				10,000 €		Komuna
o	Zgjidhja e shërbimeve të rasteve sociale		X	X	X		X			Komuna
o	Kalkulimi dhe monitorimi i treguesit të stafit		X	X	X		X			Komuna
o	Kalkulimi dhe monitorimi i treguesit të naftës		X	X	X		X			Komuna
o	Kalkulimi dhe monitorimi i treguesit të arkëtimit		X	X	X		X			Komuna
o	Monitorimi i treguesit të ankesave të klientëve		X	X	X		X			Komuna
Fushatat e informimit										
			X	X	X		X			
Total objektiva 3 - Of				5,000 €	15,100 €	115,100 €	5,100 €	3,300 €	143,600 €	

Tabela 37: Plani financiar, veprimet dhe monitorimi - Objektivi 4 „Deponimi i sigurtë si mjete i fundit“

Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjëse	Afati i implementimit dhe buxheti					Burimi financimit
		2023	2024	2025	2026	2027	
Caktimi i tarifave të shërbimit të deponimit	DSHP	5,000 €					Komuna
Eliminimi i deponive ilegale	DSHP	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	Komuna
Inspektimi dhe masat e mbrojtjes	Inspektorati	X	X	X	X	X	Komuna

Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave 2022-2026

Total objektiva 4 – Dëgjoni i sigurtë si mjeti i fundit		10,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	30,000 €
Tabela 38: Plani financiar, veprimet dhe monitorimi - Objektivi 5 „Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për MM“							
Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjëse	Afati i implementimit dhe buxheti					Burimi financimit
Revidimi i RrK të MM	DSHP	2023	2024	2025	2026	2027	2023 – 2027
Emërimi i zyrtarit / Fcilimi i njësitit	DSHP		5,000 €				Komuna
Kalimi i procesit tarifar	DSHP			3,500 €			Komuna
Kontraktimi i operatorit për grumbullim dhe transport të MK	DSHP		25,000 €				Komuna
Programi i trajnimit dhe mbështetjes së proceseve	DSHP	7,000 €	7,000 €	7,500 €	7,500 €	7,500 €	Komuna
Hartimi i planit të menaxhimit të mbeturinave në kushte emergjente pjesë e planit të emergjencave të komunes.	DSHP		3,000 €				Komuna
Total objektiva 5 – Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale		7,000 €	40,000 €	10,500 €	7,500 €	7,500 €	72,500 €